



**Dëmet nga zjarret
në vend, Rrapaj:**
Koha për masa reale
dhe sigurim ndaj
rreziqeve natyrore

Faqe 2



**Rrjetat antibreshër
- AZHBR: Skema
Kombëtare e
Investimeve grant
50% të vlerës**

Faqe 4



**Paketa e Maleve,
3308 aplikime në
E-albania - Shkodra,
qarku me interesin
më të lartë. Durrësi,
vetëm 96 aplikime**

Faqe 5



AGROBIZNESI

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

15-ditëshi i dytë i muajit gusht 2025

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 516
Çmimi 125 lekë

E përdryjavshme e pavarur

STANDARDET PRIVATE TË SUPERMARKETEVE BIMËT MJEKËSORE SHQIPTARE DREJT TREGJEVE PREMIUM TË BE-SË

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), përmes Programit Global për Cilësi dhe Standarde (GQSP), të mbështetur nga Qeveria Zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), po mbështet fermerët dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme (NVM) në përmbushjen e standardeve të kërkuara, duke lehtësuar aksesin e tyre në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare



**Bletaria në Librazhd,
sektori që njeh zhvillim
të vazhdueshëm, rreth
650 bletërritës të
mëdhenj e të vegjël**



Faqe 5

AKTUALITET

**Rama: Banesat e djegura do të bëhen të reja,
humbjet e bagëtive do të dëmshpërblehen**

Faqe 2

TEMA TË DITËS

- Çmimet e vajit të ullirit, drejt rënies? - Prodhuesi më i madh në botë, optimist pas krizës Fq.7
- Skema Kombëtare e Investimeve 2025, në Shkodër mbi 200 fermerë të interesuar në Fq.7
- Fatos Çoçoli: T'i besojmë skemës së investimeve në bujqësi? Fq.11
- Skema kombëtare e investimeve, fermerët e Kukësit aplikojnë kryesisht për ndërtimin e stallave Fq.12
- Kalendari bujqësor, muaji shtator 2025 - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

SUBVENCIONE

**Skemat mbështetëse
në bujqësi - Fermerët
e vlerësojnë ndihmën,
kërkojnë pajisjen me
dokumente pronësie**

Faqe 6

STANDARDE SIPAS BE-SË

**Takim pune me arkitektë
për standardizimin
e objekteve bujqësore
sipas normave të BE-së**



Faqe 6

TEMA TË DITËS

Dëmet nga zjarret në vend, Rrapaj: Koha për masa reale dhe sigurim ndaj rreziqeve natyrore

Pas një vale zjarresh që kanë përfshirë shumë zona të vendit, veçanërisht ato bujqësore dhe me rëndësi për agrobiznesin, dëmet janë tashmë të prekshme dhe me pasoja të thella për prodhimin, blegtorinë dhe ekonominë rurale. Në këtë intervistë, kryetari i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar, Agim Rrapaj flet për sfidat me

Në disa fusha, si vlerësimi i dëmeve në banesa apo në blegtori, ka përvorje të mjaftueshme, por kemi më pak eksperiencë në vlerësimin e dëmeve në prodhime specifike bujqësore si: ullinjë, agrumet, vreshtat dhe sidomos në tokën bujqësore, e cila në shumë raste ka pësuar dëmtime të mëdha dhe afatgjata. Këto kërkojnë më shumë

vazhdueshëm me shoqatat tona dhe agrobizneset. Fryma e tyre është bashkëpunuese, duan të mbledhin forcat dhe të përballen së bashku me pasojat. Shteti ka detyrimet e tij dhe nuk besoj se do t'u shmanget. Tani është koha për masa konkrete, si sigurimi i ushqimit për blegtorinë, por edhe mbështetje për kulturat e dëmtuara si



DËMET QË LANË PAS

FLAKËT SHKATËRRUESE DHE PASOJAT NË BUJQËSI E BLEGTORI

LIVE

EXCLUSIVE NEWS CHANNEL AFFILIATE 16:36

të cilat po përballen fermerët, hapat e nevojshëm për rehabilitimin e zonave të dëmtuara, vështirësitë në procesin e vlerësimit të dëmeve, nevojën për mbështetje të menjëhershme, si dhe domosdoshmërinë e ndërtimit të një sistemi të qëndrueshëm sigurimi për t'u përballur me rreziqet natyrore që prekin bujqësinë çdo vit.

Cilat janë zonat më të prekura nga zjarret në aspektin e agrobiznesit?

Shumica e sipërfaqeve të djegura nga zjarri ndodhen në zona bujqësore. Në të gjitha rrethet ku ka rënë zjarr, ai ka përfshirë kryesisht toka prodhuese, zona agroturizmi, sipërfaqe ku ushqehet blegtoaria, bletaria, ku grumbullohen bimë mjekësore e aromatike, apo ku kryhet agropërpunimi. Për fat të keq, zjarret kanë prekur zonat më prodhuese dhe dëmet janë të konsiderueshme.

Sa kohë merr një vlerësim i saktë i dëmeve në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë?

Duke pasur parasysh që territori i prekur është i gjerë dhe dëmet janë të shumta, që nga tokat bujqësore, pemëtaria, vreshtaria, agrumet, e deri te aktivitetet blegtorale, procesi i vlerësimit kërkon kohë. Në terren do të angazhohen disa grupe vlerësimi, por për vetë kompleksitetin e situatës, ky është një proces i vështirë dhe delikat, që duhet të zhvillohet me kujdes në mënyrë që rezultatet të jenë të drejta dhe në shërbim të të dyja palëve.

kujdes dhe ekspertizë për të garantuar një vlerësim të drejtë dhe gjithëpërfshirës.

Si mund të sigurohet që ndihma financiare të shkojë direkt tek të prekurit dhe në mënyrë të drejtë?

Nuk dua ta shoh vetëm si ndihmë financiare, pasi me përmasat që ka marrë dëmi, nuk është vetëm ndihma monetare ajo që do të japë efektin e duhur. Është e nevojshme një qasje më e gjerë dhe e mirëorganizuar për të mbështetur të gjithë zinxhirin e agrobiznesit të prekur nga kjo situatë.

Zjarret përsëriten çdo vit, por këtë herë dëmet kanë qenë më të mëdha se kurrë. Në këtë kontekst, lind natyrshëm pyetja: Pse nuk u morën masa më herët? A mund të konsiderohet i dështuar sistemi i menaxhimit të rreziqeve natyrore dhe bujqësore?

Nuk është momenti i duhur për të nxjerrë konkluzione përfundimtare mbi shkaqet, ajo që ka më shumë rëndësi në këtë moment është të mbledhim forcat dhe të nisim sa më shpejt procesin e rehabilitimit të zonave të dëmtuara.

Popullata në këto zona ka nevojë për ndihmë të shumëanshme, shëndetësore, psikologjike dhe ekonomike. Prania në terren dhe mbështetja direkte ndihmon në përshpejtimin e procesit të rehabilitimit, ndërsa për analizat dhe përgjegjësitë do të ketë kohë më pas.

Në jemi në kontakt të

ullinjë, vreshtat, agrumet dhe pemëtaria në tërësi.

Po ashtu, theksohet nevoja për të menduar për një program afatmesëm dhe afatgjatë, që të ndihmojë fermerët dhe sipërmarrjet të rikuperojnë dhe të rifillojnë aktivitetin. Na kush-ton më pak të marrim masa paraprake sesa të paguajmë për dëmet kur fatkeqësia ndodh. Jam i bindur se edhe strukturat që merren me programet e financimit do të fokusohen gjithnjë e më shumë te masat parandaluese.

A duhet krijuar një fond emergjent për raste të tilla?

Kur flasim për një paketë ndihme, ajo duhet të ketë në fund një bilanc shpenzimesh. Ne kemi aktualisht në proces një skemë mbështetëse që pritet të mbyllet në fund të shtatorit, me nëntë masa në total. Unë propozoj që një prej këtyre masave të jetë specifikisht për rehabilitimin e zonave të dëmtuara nga zjarret. Rehabilitimi pritet të jetë një proces i gjatë dhe i vështirë, ndaj është thelbësore të nxisim iniciativa që sjellin produktivitet dhe qëndrueshmëri në të ardhmen.

Ka ardhur koha të ndërtojmë një program serioz për të ardhmen dhe të përfshijmë detyrimisht procesin e sigurimit. Asnjë paketë financiare nuk mund të mbulojë plotësisht dëmet e shkaktuara nga zjarret, përmbytjet, tërmetet apo fenomene të tjera natyrore. Sigurimi është zgjidhja më e qëndrueshme dhe afatgjatë.

Rama: Banesat e djegura do të bëhen të reja, humbjet e bagëtive do të dëmshpërblehen

Kryeministri Edi Rama



deklaroi këtë të enjte se banesat e dëmtuara nga zjarret masive

të ditëve të fundit do të rindërtohen, ndërsa familjet që kanë humbur bagëtitë do të marrin dëmshpërblim të plotë për to.

Në një dalje publike në rrjete sociale, kreu i qeverisë bëri të ditur se 207 banesa janë dëmtuar si pasojë e flakëve, ndërsa 40 prej tyre janë shkrumbuar totalisht.

Ai siguroi se asnjë familje e prekur nuk do të mbetet pa ndihmë dhe se qeveria do të jetë në krah të tyre për rikthimin në një jetë normale.

“Dua t’i siguroj të gjitha familjet, si ato që kanë humbur plotësisht shtëpinë, ashtu edhe ato që kanë pësuar dëmtime, se do të marrin mbështetjen e plotë të shtetit. Ne po bëjmë

inventarizimin e dëmeve sipas protokolleve, në bashkëpunim me autoritetet përkatëse, dhe do të veprojme si gjithmonë: askush nuk do të mbetet vetëm. Shtëpitë do të rindërtohen më të mira dhe më të forta,” tha Rama.

Kryeministri shtoi se përveç dëmeve në banesa, do të kompensohen edhe humbjet në blegtori. Deri tani janë raportuar 3,916 krerë bagëti të humbura nga zjarret, dhe sipas Ramës, dëmshpërblimi do të bëhet për çdo rast.

“Do të kompensojmë një për një çdo krerë të humbur, pa asnjë diskutim,” tha ai, duke nënvizuar se procesi i evidentimit të plotë të dëmeve është ende në vijim.

Turqia e gatshme të investojë në bujqësi, marrëveshje mes DHTIT dhe Dhomës së Antalias

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë dhe Dhoma Ekonomike e Antalias nënshkruan në Tiranë, një marrëveshje bashkëpunimi që synon forcimin e tregtisë dypalëshe, me fokus të veçantë në sektorët e bujqësisë dhe industrisë ushqimore.

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është lehtësimi i shkëmbimit të njohurive dhe përvojës mes dy palëve, si dhe forcimi i ndërveprimit institucional ndërmjet dy dhomave.

Në këtë takim ishin të pranishëm kryetari i Dhomës Ekonomike të Antalias, Ali Çandir, ambasadori i Turqisë në Shqipëri, Tayyar Kagan Atay, si edhe një delegacion biznesi me rreth 50 sipërmarrës nga Turqia dhe përfaqësues shtetëror.

“Forcimi i marrëdhënieve ekonomike midis dy vendeve, rritja e shkëmbimeve tregtare

dhe investimet, promovimi i zhvillimit në aktivitetet e përbashkëta, misionet tregtare, forumet, konferencat, janë misioni i punës tonë të përbashkët me sipërmarrjen turke. Shkëmbimet tregtare midis vendeve tona janë të qëndrueshme, ndërkohë që ekzistojnë mundësi mjaft të mëdha për zgjerimin e tyre”, u shpreh, këshilltari ekonomik i DHTIT, Bashkim Sykja.

Çandir theksoi se Turqia është e gatshme të investojë në Shqipëri, veçanërisht në sektorin e bujqësisë, ndërsa ftoi sipërmarrësit shqiptarë të shqyrtojnë mundësitë për eksport drejt Turqisë, pasi ky vend ofron një treg shumë premtues.

“Bashkëpunimi ekonomik me Antalian nuk është në nivelin e duhur, prandaj kjo mbledhje është shumë e rëndësishme për ne, investitorët tanë janë

shumë të interesuar dhe janë të gatshëm që të nisin nga puna dhe është shumë e mundur që të importojmë produktet e qumështit e mishit, në bujqësi, ne jemi të gatshëm që të investojmë në gjithçka që të bëjë më bujqësinë. Nga ana tjetër, prodhimtaria e Shqipërisë mund të eksportohet në Turqi sepse atje ka treg të mirë”, deklaroi kryetari i Dhomës së Tregtisë së Antalias, Ali Çandir.

Takimi u përmbyll me sesione B2B ndërmjet bizneseve shqiptare dhe atyre turke të pranishme në aktivitet.

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë thotë se mbetet e përkushtuar në ndërtimin e urave të bashkëpunimit ndërkombëtar që sjellin vlera konkrete për ekonominë shqiptare dhe rritje të qëndrueshme për sipërmarrjen vendase.

Dhoma Amerikane e Tregtisë mbështet strategjinë afatgjatë për zhvillimin e turizmit në Shqipëri

Dhoma Amerikane e Tregtisë në vendin tonë (AmCham), nëpërmjet Komitetit të Turizmit dhe Mikpritjes ka ndjekur me interes zhvillimet në sektorin e turizmit dhe hartimin e strategjisë afatgjatë, si një dokument strategjik i domosdoshëm për zhvillimin e sektorit.

Përmes një deklarate për mediet, ‘AmCham’ shprehet se ka qenë një kërkesë e hershme e saj zhvillimi dhe zbatimi i një vizioni strategjik, që i jep përparësi qëndrueshmërisë afatgjatë duke ndërmarrë masat e nevojshme me zhvillimin e një

kuadri të ri rregullator dhe përcaktimin e qartë të metodave të menaxhimit të destinacioneve. “AmCham këmbëngul në mendimin e vet se vetëm përmes kësaj qasje që kërkon ndryshime themelore, mund të zhvillojmë një sektor të qëndrueshëm që respekton trashëgiminë natyrore e kulturore, duke promovuar praktika që mbështesin mjedisin dhe komunitetet. Kjo do të mundësojë që Shqipëria të bëhet një destinacion i rëndësishëm turistik në Evropë ku çmimet dhe cilësia ofrojnë pushime për të gjithë”, thuhet në deklaratë.

Sipas AmCham, vizioni për turizmin 2030, i hartuar edhe me pjesëmarrjen e grupeve të interesit të industrisë, përbën themelin mbi bazën e të cilit do të ndërtohen dhe harmonizohen të gjitha nismat strategjike.

“Dhoma Amerikane do të ndjekë me mjaft interes zbatimin e kësaj strategjie në vijim edhe të rekomandimeve të hartuara nga Komiteti i Turizmit dhe Mikpritjes që prekin fushat e akomodimit, udhëtim-it dhe transportit, agroturizmit, si dhe konsulencën dhe trajnime”, thuhet më tej.

STANDARDET PRIVATE TË SUPERMARKETEVE

BIMËT MJEKËSORE SHQIPTARE DREJT TREGJEVE PREMIUM TË BE-SË

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), përmes Programit Global për Cilësi dhe Standarde (GQSP), të mbështetur nga Qeveria Zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), po mbështet fermerët dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme (NVM) në përmbushjen e standardeve të kërkuara, duke lehtësuar aksesin e tyre në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare

Për kë është ky artikull?

Ky artikull është përgatitur posaçërisht për eksportuesit, përpunuesit dhe fermerët shqiptarë që janë të interesuar të furnizojnë rrjete supermarketesh dhe tregje premium të Bashkimit Evropian me bimë aromatike dhe mjekësore (BAM). Në një kohë kur tregjet globale po bëhen gjithnjë e më të ndërlikuara dhe konkurrenca po rritet me shpejtësi, suksesi në eksport nuk varet më vetëm nga prodhimi i një produkti të mirë, por nga aftësia për t'iu përmbajtur standardeve shumë të rrepta të cilësisë, sigurisë dhe qëndrueshmërisë që kërkohen nga blerësit ndërkombëtarë. Për fermerët dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme (NVM), hyrja në këto tregje ofron një mundësi të jashtëzakonshme për rritje, diversifikim dhe fitime më të larta, por kërkon gjithashtu një nivel të lartë profesionalizmi, organizimi dhe përkushtimi ndaj standardizimit.

Çfarë janë standardet private të supermarketeve?

Përtej kërkesave ligjore të BE-së dhe certifikimeve ndërkombëtare të njohura si **GLOBALG.A.P.** apo **Organic**, shumë rrjete supermarketesh në Evropë vendosin edhe standarde të brendshme të cilësisë. Këto njihen si **standardet private të supermarketeve** dhe shpesh janë më të rrepta sesa legjislacioni ekzistues. Për shembull, **Tesco Nurture** është një standard i përdorur nga rrjeti britanik Tesco për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e produkteve bujqësore. Po ashtu, **NaturLand**, **Demeter** dhe **Bio Suisse** janë certifikime shtesë që lidhen me bujqësinë organike dhe biodinamike, duke ofruar garanci shtesë për konsumatorët që kërkojnë produkte me cilësi shumë të lartë. **FairWild** është një standard i krijuar posaçërisht për produktet që mbliken nga natyra, duke siguruar që ky proces të kryhet në mënyrë të qëndrueshme, pa dëmtuar biodiversitetin dhe duke garantuar të ardhura të drejta për komunitetet lokale. Ndërkohë, **BRC** dhe **IFS Food** janë standarde për fabrikat e përpunimit, që sigurojnë se produktet janë trajtuar sipas protokolleve më të rrepta të sigurisë ushqimore.

Këto standarde janë bërë një element i domosdoshëm për eksportuesit që duan të hyjnë në tregjet premium, sepse blerësit kërkojnë jo vetëm produkte të shëndetshme dhe të sigurta, por edhe furnizues që mund të garantojnë gjurmueshmëri të plotë, praktika të qëndrueshme dhe respektim të përgjegjshëm socialë. Për këtë arsye, ato janë një pengesë e madhe për ata që nuk janë të përgatitur, por një pasaportë e artë për ata që arrijnë t'i përmbushin.

Çfarë i dallon këto standarde nga certifikimet ligjore?

Nëse legjislacioni i BE-së vendos rregulla bazë për përdorimin e pesticideve, sigurinë ushqimore dhe gjurmueshmërinë, standardet private shkojnë shumë më tej. Për shembull, në rastin e pesticideve, ndërsa ligji kërkon vetëm respektimin e kufijve maksimalë të mbetjeve (MRL), shumë supermarkete kërkojnë që këto të jenë më pak se gjysma e kufirit ligjor dhe të përdoren shumë më pak lloje substancash kimike. Gjurmueshmëria, e cila në nivel ligjor kërkohet në formë bazike, për standardet private duhet të jetë e plotë dhe e përforcuar me sisteme elektronike dhe auditime të rregullta.

Elementi	Kërkesat ligjore (BE)	Standardet private
Përdorimi i pesticideve	Respektimi i MRL-ve	Shpesh kërkojnë ≤ 50% të MRL dhe kufizim të llojeve të pesticideve
Gjurmueshmëria	E detyrueshme në nivel bazik	Sisteme të përforcuara me gjurmim elektronik dhe auditime të shpeshta
Trupat e huaj	Jo të lejuar	Standard shumë më i lartë për pastërtinë dhe inspektim optik
Përgjegjësia sociale/mjedisore	Jo e detajuar	Përfshin kushte pune, pagë të drejtë, mbrojtje të biodiversitetit dhe klimës

Edhe përsa i përket pastërtisë fizike të produktit, kërkesat janë më të larta: nuk mjafton që produkti të jetë i lirë nga trupat e huaj, por ai duhet të kalojë inspektime të imta, shpesh me pajisje optike që zbulojnë edhe grimcat më të vogla. Një tjetër element i rëndësishëm është përgjegjësia sociale dhe mjedisore. Ligji i BE-së nuk është shumë i detajuar në këtë drejtim, por standardet private kërkojnë të dhëna konkrete mbi kushtet e punës, pagesën e drejtë të punëtorëve, si dhe masat që ndërmerren për mbrojtjen e mjedisit. Kjo do të thotë se, në praktikë, eksportuesi duhet të jetë i gatshëm të tregojë jo vetëm një produkt të mirë, por edhe një histori të mirë – një tregim që lidhet me qëndrueshmërinë, etikën dhe transparencën.

Përfitimet e hyrjes në tregjet premium

Përpjekja për të përmbushur këto standarde të rrepta shpërblehet me një sërë përfitimesh afatgjata. Së pari, produktet që certifikohen sipas standardeve private mund të shiten me **çmime dukshëm më të larta**, sepse konsumatorët e tregjeve premium janë të gatshëm të paguajnë më shumë për cilësi të garantuar dhe për sigurinë që ofrojnë këto certifikime. Së dyti, prodhuesit dhe eksportuesit që arrijnë të hyjnë në këto rrjete fitojnë **marrëveshje**

afatgjata dhe të qëndrueshme me blerës seriozë, gjë që u siguron stabilitet financiar dhe planifikim më të mirë të aktivitetit.

- **Çmime më të larta** për produkte me cilësi të garantuar.
- **Marrëveshje afatgjata** me rrjete supermarketesh dhe blerës seriozë.
- **Qasje në tregje të specializuara** si bio, gourmet apo farmaceutike.
- **Rritje e reputacionit ndërkombëtar** si furnizues i besueshëm.

Një përfitim tjetër i madh është hyrja në **tregje të specializuara** si ato organike, gourmet apo farmaceutike, ku produktet e BAM-ve shqiptare mund të përdoren për çajra mjekësorë, përbërës farmaceutikë ose ushqime me vlerë të shtuar. Në fund, certifikimi sipas këtyre standardeve rrit **reputacionin ndërkombëtar** të Shqipërisë si një vend furnizues serioz dhe i besueshëm, duke hapur rrugën për zgjerim të mëtejshëm dhe për investime të huaja.

Si të përgatiteni për një skemë private cilësie?

Për të hyrë në një rrjet supermarketesh premium, hapi i parë është gjithmonë **konsultimi me blerësin**. Çdo supermarket ka kërkesa të ndryshme dhe është e rëndësishme të kuptohet se cilin certifikim apo standard kërkon. Pas kësaj, eksportuesi duhet të **aplikojë për certifikimin përkatës**, gjë që shpesh përfshin një proces të gjatë përgatitor. Një element thelbësor është **trajnimi i stafit** – që nga punonjësit e fushës deri te ata të fabrikës – në mënyrë që të gjithë të kuptojnë se cilat janë rregullat dhe si duhet të zbatohen ato.

Po aq e rëndësishme është ngritja e **sistemeve të forta dokumentimi dhe gjurmueshmërie**. Çdo hap, nga mbledhja e bimëve në natyrë apo nga kultivimi në fermë deri te përpunimi dhe paketimi, duhet të dokumentohet dhe të jetë i verifikueshëm. Përveç kësaj, është e këshillueshme që kompanitë të kryejnë **auditime të brendshme dhe analiza laboratorike të rregullta**, për të siguruar se nuk do të ketë surpriza gjatë inspektimeve nga palët e treta.

Shembuj praktikë nga rajoni

Rajoni i Ballkanit ka disa përvoja të vlefshme që tregojnë rrugën drejt suksesit. Në Maqedoninë e Veriut, një kooperativë bujqësore furnizon rrjetin zviceran **Migros** me rigon të tharë, duke mbajtur certifikimin **Bio Suisse** dhe **GLOBALG.A.P.** Ky është një shembull se si një grup fermerësh të organizuar mund të hyjnë në një nga tregjet më të ndjeshme dhe të kërkuara të Evropës.

Edhe në Shqipëri po shfaqen nisma të ngjashme. Në zonën e Skraparit dhe Kukësit, disa eksportues kanë nisur procesin për certifikimin **FairWild**, i cili u jep atyre mundësinë të furnizojnë tregjet premium me produkte të mbledhura në mënyrë të qëndrueshme nga natyra. Këto raste dëshmojnë se, me organizim, bashkëpunim dhe përkushtim ndaj standardeve, edhe prodhuesit shqiptarë mund të bëhen pjesë e zinxhirit të furnizimit për rrjetet më prestigjioze të Evropës.

Këshilla praktike për sukses në tregjet premium

Për të arritur sukses, nuk mjafton të kesh një produkt të mirë; është e domosdoshme të kesh edhe një qasje profesionale ndaj tregut. Kjo fillon me **investimin në paketim cilësor dhe etiketim të saktë**, sepse për konsumatorët premium, pamja e jashtme është po aq e rëndësishme sa edhe cilësia e brendshme. Gjithashtu, rekomandohet përdorimi i **pajisjeve moderne për pastrim dhe inspektim optik** të produkteve të thata, për të garantuar që produktet janë të pastra dhe të njëtrajtshme.

- Investoni në **paketim cilësor dhe etiketim transparent**.
- Përdorni **pajisje moderne për pastrim dhe inspektim optik** të produkteve të thata.
- Bashkëpunoni me **agjentë certifikimi me eksperiencë ndërkombëtare**.
- Ndiqni me rigorozitet çdo detaj të standardeve – **mos improvizoni**.

Një hap tjetër i rëndësishëm është bashkëpunimi me **agjentë certifikimi me përvojë ndërkombëtare**, të cilët mund të udhëzojnë kompaninë përmes procesit të certifikimit dhe të ndihmojnë në shmangien e gabimeve të kushtueshme. Dhe mbi të gjitha, është thelbësore që prodhuesit dhe eksportuesit të **mos improvizojnë**, por të ndjekin me rigorozitet çdo detaj të kërkuar nga standardet përkatëse. Vetëm në këtë mënyrë mund të sigurohet besimi i blerësve dhe të arrihet qëndrueshmëria në tregjet premium.

Shumë blerës mund të refuzojnë një produkt edhe nëse ai është teknikisht i lejuar nga ligji, nëse nuk i përmbush kërkesat e tyre të brendshme të cilësisë. Kjo është një pikë kritike që shpesh nuk kuptohet nga prodhuesit: suksesi nuk varet vetëm nga ligjshmëria e produktit, por nga **aftësia për të përmbushur pritshmëritë e brendshme të rrjeteve premium**. Hyrja në tregjet premium të Bashkimit Evropian është një sfidë komplekse, por edhe një mundësi e jashtëzakonshme për fermerët dhe eksportuesit shqiptarë të bimëve aromatike dhe mjekësore. Ajo kërkon **përkushtim të vazhdueshëm, investime në certifikim dhe respektim të rreptë të standardeve private**, por përfitimet që sjell janë të mëdha: çmime më të larta, marrëveshje afatgjata, qasje në tregje të specializuara dhe rritje të reputacionit ndërkombëtar. Për ata që janë të gatshëm të ndjekin këtë rrugë, tregjet premium të BE-së ofrojnë jo vetëm një fitim ekonomik, por edhe një shans për të ndërtuar një model zhvillimi të qëndrueshëm dhe të respektuar globalisht.

INFORMACIONE

Mbrojtja pronësisë së markave tregtare, patentave dhe shpikjeve, Gonxhja: Më 16 gusht nis nga zbatimi ligji i ri

Blendi Gonxhja, Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, ka apeluar tek të gjitha subjektet e interesuara se më 16 gusht 2025 hyjnë në fuqi dy ligje të rëndësishme:

- Ligji për markat tregtare
- Ligji për patentat dhe certifikatat e mbrojtjes shtesë.

Këto ligje janë një ndryshim i madh në kuadrin ligjor për pronësinë e markave tregtare



në Shqipëri, duke sjellë rregulime të reja dhe më të detajuara për mbrojtjen e markave dhe shpikjeve. Është e rëndësishme që bizneset dhe individët të informohen për ndryshimet dhe të marrin masat e nevojshme, shkruan rtsh.al.

Ligj ka për qëllim të rregullojë në mënyrë të plotë marrëdhëniet juridike mbi markat tregtare në Shqipëri. Qëllimi kryesor është shpikja e rregullimit të markave nga ligji ekzistues “Për Pronësinë Industriale” dhe përfirimi i plotë me standardet evropiane, duke pasqyruar direktivat e BE-së, siç specifikohet në referencat e dokumentit.

Ndryshimet kryesore të sjella nga ligji i ri

Ky ligj sjell një kuadër të ri rregullator dhe funksional, me

ndryshime të rëndësishme që prekin proceset, organet dhe mbrojtjen e markave.

Përkufizime dhe fusha e veprimit

Ligji ofron përkufizime të qarta për terma si markë tregtare, markë kolektive, markë certifikuese, dhe markë e mirënjohur. Fusha e tij e veprimit përfshin të gjitha llojet

Përveç kësaj, ligji përcakton një mbrojtje të veçantë për markat me reputacion të mirë, duke i mbrojtur ato edhe në rastet kur mallrat ose shërbimet nuk janë të ngjashme. Ligji gjithashtu adreson shkeljet, duke i dhënë pronarit të markës të drejtën të ndalojë edhe veprimet përgatitore, si përdorimi i paketimit të falsifikuar.

Rregullat mbi pronësinë dhe përdorimin

Marka tregtare mund të transferohet si objekt pronësie, por duhet të regjistrohet me shkrim. Ligji, shkruan rtsh.al, gjithashtu thekson rëndësinë e përdorimit real dhe efektiv të markës brenda një periudhe 5-vjeçare nga regjistrimi, pasi mospërdorimi mund të sjellë shfuqizimin e saj.

Ndryshimet në strukturën administrative

Për të përmirësuar efikasitetin dhe për të adresuar ankesat administrative, ligji krijon tre organe të reja brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI):

Dhoma e Kundërshtimeve: Shqyrton kundërshtimet ndaj regjistrimeve të reja.

Dhoma për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri: Shqyrton kërkesat për shfuqizimin ose deklarimin e pavlefshmërisë së markave ekzistuese.

Bordi i Apelit: Shërben si instancë ankimi për vendimet e marra nga dhomat.

Ky ligj e forcon ndjeshëm kuadrin ligjor për markat tregtare në Shqipëri, duke e bërë atë më të qartë, më mbrojtës ndaj pronarëve dhe më të harmonizuar me standardet ndërkombëtare.

e kërkesave për regjistrim, duke përfshirë edhe regjistrimet ndërkombëtare.

Kriteret e regjistrimit

Sistemi i ri detajon shkaqet absolute dhe relative për refuzim. Një ndër pikat më të rëndësishme është parashikimi që një markë mund të refuzohet nëse kërkesa është bërë në keqbesim, një mekanizëm i ri që synon të mbrojtë pronarët nga regjistrimet e paautorizuara nga agjentët.

Mbrojtja e të drejtave

Pronari i markës tregtare gëzon të drejta ekskluzive dhe ka të drejtë të ndalojë palët e treta nga përdorimi i një shenje identike ose të ngjashme, që mund të shkaktojë konfuzion.

Rrjetat antibreshër - AZHBR: Skema Kombëtare e Investimeve grant 50% të vlerës

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, përmes Skemës Kombëtare të Investimeve mbështet me financim fermerët për instalimin e rrjetave antibreshër në blloqe ekzistuese me të mbjella bujqësore.

Sipas AZHBR-së, Skema Kombëtare e Investimeve financon rrjetat për mbrojtjen nga breshëri në blloqet ekzistuese me pemë frutore, agrume dhe vreshta, për sipërfaqe nga 1 ha deri në 5 ha.

“Masa e përfitimit është 50% e vlerës totale të investimit dhe shkon deri në 1.5 milionë lekë për hektar. Përmes përfitimit të 50% grant nga skema dhe kombinimit me Kredinë e Butë me interes vetëm 2% dhe garanci sovraane prej 70% të kolateralit, fermerët sigurojnë financim të plotë për të gjithë investimit”,

njofton AZHBR.

Përfitues të mundshëm të skemës janë fermerë, subjekte me status fizik/juridik, sho-



qëritë e bashkëpunimit bujqësor. Aplikantët nuk duhet të jenë debitorë ndaj AZHBR dhe MBZHR.

Në rastet e fermerëve indi-

vidualë, duhet të kenë tokën në pronësi ose me qira të paktën për 5 vite nga viti i aplikimit.

Aplikimet e Skemës Kom-

bëtare të Investimeve 2025 kryhen pranë zyrave qendrore të AZHBR deri më 30 shtator për investime në sektorin bujqësor me 9 masa mbështetëse.

Murtaja në derra dhe sëmundja e shpendëve, MBZHR ndalon importin nga disa shtete

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka ndaluar importin e shpendëve të prekur nga sëmundja e pseudopestit nga shtetet si Bullgaria e Polonia, si dhe të derrave të butë e të egër të prekur nga murtaja afrikane në vendet si Estonia, Letonia, Kroacia, Polonia, Estonia, Bosnjë-Hercegovina, Serbia dhe Moldavia.

Në vendimin e publikuar në fletoren zyrtare, nënvizohet se ndalohet importi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve, mishit të freskët, materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test PCR të kryer në 14 ditët e fundit.

MBZHR njofton se importet nga shtetet e Bullgarisë, Polonisë dhe Spanjës lejohen, nga zona dhe stabilimente të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

Po ashtu, me vendim të ministres Anila Denaj, është ndaluar importi i kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, mi-shi i freskët dhe produktet e tij, materiali biologjik dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit

e thatë të kafshëve shtëpiake dhe vakteve proteinike.

Ndërkaq, Ministria ka ndaluar importet nga Italia, Serbia, Greqia, Kosova dhe Kroacia të bagëtive të gjalla të imëta dhe thundrake, të llojit



derra, duke përfshirë mishin në një kontenier të vulosur hermetikisht, xhelatinën, ushqimin

ruminantë dhe kamelidë, të prekura nga sëmundja e gjuhës blu.

Blegtoria, drejt një plani zhvillimi të qëndrueshëm - Studim strategjik në 13 njësitë rurale të Tiranës

Bashkia Tiranë ka shpallur hapjen e tenderit për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit për zhvillimin e sektorit të blegtorisë.

Referuar dokumentit në Agjencinë e Prokurimit Publik, studimi i fizibilitetit dhe plani i biznesit për zhvillimin e sektorit të blegtorisë ka si qëllim të analizojë, identifikojë dhe hartojë politika, strategji sektoriale në funksion të zhvillimit të blegtorisë, si dhe të drejtë dhe mbështetëse në rritjen dhe përmirësimin e ekonomisë në zonat rurale të Bashkisë Tiranë.

Gjithashtu, synon të përcaktojë mundësitë dhe sfidat e

Vaqarr, Kashar, Pezë, Ndroq, Zall-Herr. Ky studim do të lehtësojë orientimin e investimeve vendore, qendrore apo edhe ato të huaja për zhvillimin e mëtejshëm sipas zonave, duke iu referuar dhe statusit të përditësuar nëse ka një plan për zhvillimin e zonës, në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi.

Aktualisht, ky sektor përballë me mungesën e studimeve në të gjitha fushat duke filluar nga tipet e fermave, format strukturore dhe organizative, format e menaxhimit dhe efektiviteti ekonomik. Mungesa e të dhënave sjell dhe mungesë për zhvillimin e këtij sektori dhe kjo paraqet një

blegtoral bazuar në kullotë; burime njerëzore, duke iu referuar të rinjve në fermë, specialistëve të fushës (agronomë, veterinerë, zooteknikë); infrastrukturë: pajisje, asistencë teknike, nevoja për aftësimin profesional; të identifikojë burime të mundshme të financimit dhe të vlerësojë kostot e nevojshme për të realizuar projektet për zhvillimin e sektorit të blegtorisë.

Po kështu, pritet të identifikojë mundësitë e financimit: fermerët ekzistues, mikrokre-di, mekanizma miks, bashkë-financim; si dhe të analizojë impaktin social, ekonomik dhe mjedisor, duke përfshirë



sektorit të blegtorisë për rritjen dhe avancimin e këtij sektori në 13 Njësitë Administrative Rurale të Bashkisë Tiranë, konkretisht në: Petrelë, Farkë, Dajt, Zall-Bastar, Bërzhitë, Krrabë, Baldushk, Shëngjergj,

nevojë imediate për vlerësim, në funksion të zhvillimit të blegtorisë.

Referuar dokumentit, plani i biznesit dhe studimi i fizibilitetit do të identifikojë mundësitë për rritje të sektorit

përfitimet dhe rreziqet potenciale. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave është deri më 18 gusht 2025, ora 10:00. Fondi limit i përlogaritur është 5 milionë e 820 mijë lekë pa TVSH.

BUJQËSI

Përfundon faza e parë e kontrolleve në terren për sigurinë ushqimore - Tatimet: U bllokuan 103 ton mallra

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve ka përfunduar fazën e parë të kontrolleve në terren, si pjesë e përpjekjeve të saj të vazhdueshme për forcimin e ligjshmërisë fiskale në sektorin e produkteve bujqësore dhe blegtorale. Gjatë këtij operacioni, janë bllokuar plot 103 ton mallra, ndërsa 283 subjekte janë inspektuar në total.

“Gjatë kësaj faze janë kontrolluar gjithsej 283 subjekte, duke rezultuar në bllokimin e 103 ton mallra, për shkak të shkeljeve të konstatuara në lidhje me dokumentacionin fiskal dhe rregullsinë e qarkullimit të produkteve.

Autoritetet njoftojnë se ka nisur faza e dytë e monitorimit, e cila do të fokusohet në verifikimin e vazhdueshëm të shoqërimit të produkteve me faturë tatimore, me qëllim evidentimin dhe ndëshkimin e çdo subjekti që operon në informalitet.

Qëllimi i këtij aksioni është i qartë:

Formalizimi i tregut, Rritja e sigurisë ushqimore, Mbrojtja e konsumatorit”-

sqarohet në njoftim.

Tatimet bëjnë të ditur se nuk do të lejojnë asnjë tolerim ndaj

bizneseve që shkelin ligjin duke shitur produkte bujqësore apo blegtorale pa lëshuar faturë.



20 DITË

nga përpjekja për formalizimin e tregut të produkteve bujqësore/blegtorale dhe rritjen e sigurisë ushqimore

REZULTATET

103 TON

sasia totale e mallrave të bllokuar

283 SUBJEKTE

të inspektuara Total

www.tatime.gov.al

Deri në 5 milionë lekë për mekanikë bujqësore - Financim 50% të vlerës totale të faturave tatimore!

Sipas Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, vitin e kaluar kërkesat më të larta për financim përmes Skemës Kombëtare



të Investimeve, ishin për blerjen dhe përmirësimin e mjeteve dhe mekanikës bujqësore.

Qeveria përmes kësaj skeme financon 50% të vlerës totale të faturave tatimore, deri në 5

milionë lekë për subjekt.

Ky investim mbështet fermerët në modernizimin e bujqësisë dhe blegtorisë, për

masa, që përfshin gjithë bujqësinë që nga mbjellja e fidanëve të pemëve frutore deri në përpunimin e fruta-perimeve. Këtu përmblidhen mekanika, blegtorja, ndërtimi i stallave, bletaria.

Aplikimet për të përfutur nga kjo skemë janë hapur më 30 korrik dhe do të vazhdojnë deri më 30 shtator 2025.

Ndërkohë vitin e kaluar nga 404 aplikime në Skemën Kombëtare të Investimeve 2024, 305 kërkesa janë për mekanikë bujqësore.

Për mekanikën bujqësore vlera mesatare për fermerë shkon 30 deri 36 mijë euro ku 50 % financohet grant nga Skema e Investimeve. Ndërsa pjesa tjetër do të paguhet nga fermeri, fond të cilin fermeri mund ta marri kredi në bankë duke përdorur Fondin e Garancisë Sovrane ku shteti mbështet 80% të kolateralit.

realizimin e punës në mënyrë më efikase dhe të sigurt, për të përmirësuar jetën dhe prodhimin e tyre

Skema Kombëtare e Investimeve 2025, përmblidh nëntë

Bletaria është i vetmi sektor që ka qëndrueshmëri dhe zhvillim në bashkinë e Librazhdit.

Të dhënat nga Drejtoria e Bujqësisë në këtë bashki flasin për dhjetëra bletërritës që administrojnë parqe të mëdha e qindra të tjerë më të vegjël.

“Aktualisht fermerët aktivë që konkurrojnë në skemat përfituese janë me 30–40

koshere, ndërsa fermerët që kanë 5–15 koshere janë më në shumicë, rreth 500–600,” tregon Hysni Hoxha nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Turizmit.

Ky vit ka qenë i mbarë për bletarinë dhe Hoxha shton se të gjithë fermerët raportojnë për



Mbështetje financiare për ndërtimin e serrave diellore - 50% grant për prodhimin e perimeve, rrushit dhe luleshtrydheve

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në kuadër të Skemës Kombëtare të Investimeve 2025, ofron financim të pjesshëm për ndërtimin e serrave diellore. Fermerët që dëshirojnë të investojnë në prodhimin e perimeve, luleshtrydheve dhe rrushit të tavolinës

mosdoshme për kultivimin e këtyre kulturave.

MBËSHTETJA FINANCIARE:

Deri në 15 mln lekë/ha për serrat e prodhimit të perimeve

Deri në 8 mln lekë/ha për serrat e prodhimit të rrushit për



mund të përfitojnë grant prej 50% për ndërtimin e serrave që shtrihen nga 0.2 ha deri në 2 ha, përfshirë gjithashtu edhe sistemet e ujitjes që janë të do-

tavolinë

Deri në 4 mln lekë/ha për serrat e prodhimit të luleshtrydheve

Kjo mbështetje financiare është e strukturuar në mënyrë

që të ndihmojë investimet e ndryshme të bujqësisë. Për serrat e prodhimit të perimeve, fermerët mund të përfitojnë deri në 15 milionë lekë për çdo hektar, ndërsa për serrat e prodhimit të rrushit të tavolinës mund të sigurojnë deri në 8 milionë lekë për hektar. Për serrat e prodhimit të luleshtrydheve, mbështetja arrin deri në 4 milionë lekë për hektar.

Sipas ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, fermerët mund të përfitojnë këtë grant prej 50% në kombinim me mundësinë për të marrë një kredi të butë me interes prej vetëm 2% dhe një garanci sovraane që mbulon deri në 70% të kolateralit të nevojshëm për këtë investim. Aplikimet për këtë skemë janë të hapura deri më datë 30 shtator dhe përfshihen gjithsej 9 masa mbështetëse që synojnë të përmirësojnë produktivitetin dhe cilësinë e prodhimit në bujqësi.

Paketa e Maleve, 3308 aplikime në E-albania - Shkodra, qarku me interesin më të lartë. Durrësi, vetëm 96 aplikime

Më shumë se 3 mijë e 300 qytetarë kanë aplikuar deri më tani për Paketën e Maleve. Kjo nismë e ndërmarrë nga qeveria ka ngjallur interes të lartë që nga momenti i hapjes së aplikimeve e deri më tani, pasi synon të nxisë investimet dhe t'i shërbejë ekonomisë lokale në zonat malore të Shqipërisë.

Deri më tani, Shkodra është qarku me më shumë aplikime, plot 687 të tilla, e ndjekur nga Vlora, Elbasani, Kukësi dhe për të përfunduar me qarkun e Durrësit që ka shënuar vetëm 96 aplikime.

Aplikimet janë të hapura deri në fund të vitit, ndërsa vetëm 500 qytetarët e parë që do të përfundojnë projektin e tyre do të përfitojnë lehtësi fiskale për 10 vite. Aplikimet për këtë nismë do të vijojnë përgjatë gjithë vitit për qytetarët dhe emigrantët që duan të investojnë në Shqipëri.

Kushdo që ka një ide për të zhvilluar zonat malore të Shqipërisë, qoftë individ me pasion për natyrën, biznes i vogël

apo i madh, banor vendas apo shqiptar nga diaspora që dëshiron të rikthehet te rrënjët mund

të miratuar nga bashkia dhe qeveria dhe të dorëzohet një plan zhvillimi konkret që ruan



të aplikojë, edhe ata që prej më shumë se 10 vitesh përdorin një tokë shtetërore, mund ta legalizojnë atë përmes kësaj pakete.

Kushtet për të përfutur janë që prona të jetë tokë shtetërore që nuk është pyll, kullotë apo pronë ushtarake. Të jetë përdorur faktikisht për më shumë se 10 vite. Të ndodhet në një zonë malore me përparësi zhvillimi

natyrën dhe traditën.

500 aplikimet e para që përmeshin kushtet dhe realizojnë projektin, për 10 vite do të operojnë pa asnjë taksë. Zero TVSH, zero tatim mbi fitimin, zero taksë pasurie dhe zero taksë infrastrukture. Për më tepër, në fund të zhvillimit, prona kalon në emrin e qytetarit për vetëm 1 euro.

Bletaria në Librazhd, sektori që njeh zhvillim të vazhdueshëm, rreth 650 bletërritës të mëdhenj e të vegjël

më shumë mjaltë të prodhuar me cilësi shumë të mirë.

Mjalti i Librazhdit, qoftë ai i gështenjave, i luleve apo i pishës, tregun e ka të sigurt.

“Normalisht fermerët kanë klientelën e vet ku tregtojnë. Nuk është se u ngelet mjaltë.

Sidomos mjalti i gështenjës në zonën e Gurakuqit, por edhe mjalti i luleve, si ai i Sopotit,” thotë z. Hoxha.

Bletaria në zonën e Librazhdit është një traditë e hershme, e cila po merr zhvillim jo vetëm për shkak të mjedisit të përshtatshëm me pyje, male e kullota për t'u zhvilluar, por edhe për shkak të politikave mbështetëse zhvilluese ndaj këtij sektori.

AKTUALITET

Takim pune me arkitektë për standardizimin e objekteve bujqësore sipas normave të BE-së

Ekspertë të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, bashkë me ekspertë të huaj dhe arkitektë dhe studio arkitekture, diskutuan në Tiranë rreth identifikimit të sfidave dhe përcaktimit e hapave të mëtejshëm në drejtim të hartimit të stallave blegtorale dhe objekteve bujqësore sipas standardeve të Bashkimit Europian për fermerat blegtorale.

Ky takim shënoi një hap konkret drejt modernizimit të infrastrukturës bujqësore dhe blegtorale në vend, duke theksuar rëndësinë që ka arkitektura në zhvillimin rural, mirëqenien e kafshëve dhe përgatitjen për sfidat mjedisore dhe ekonomike të së ardhmes.

Gjatë takimit u trajtuan çështje që kanë të bëjnë me:

Boshllëqet aktuale në projektimin e objekteve bujqësore; Sfidat praktike dhe ato rregulatore që hasin arkitektët dhe

MBZHR dhe Giz Albania vijon të fuqizojë dialogun ndërmjet sektorit publik dhe atij privat, duke nxitur shkëm-



Takim me arkitektët vendas për përmirësimin e ndërtimeve të reja blegtorale.

fermerët dhe nevoja për krijimin e një strukture përfaqësuese të aktorëve të përfshirë në këtë fushë.

bimin e ideve dhe zgjidhjeve të përbashkëta në fushën e zhvillimit rural dhe bujqësisë së qëndrueshme.

Gjirokastrë - Ndërrhyrjet në kanalet vaditëse, janë pastruar 54 km kanale dhe po punohet për kullimin

Ndërrhyrjet në kanalet e vaditjes kanë qenë intensive këtë sezon vere nga Bashkia e Gjirokastrës. Sipas Iljaz Memushit, drejtor i Pyjeve, Kullotave, Ujitjes dhe Kullimit,

sa po bëhen përgatitjet edhe për ndërrhyrjet në kanalet kulluese.

“Janë bërë rreth 54 km linja kanalesh vaditëse. Aktualisht edhe po doli ndonjë problematikë gjatë sezonit të vaditjes,

ajo e Cepos, e cila mbahet gjithmonë nën vëzhgim, sepse ujitet nga përroi. Në qoftë se do të respektojnë radhën e njëritjetrit atëherë çdo furnizim i secilës parcelë është më i kollajtë,” thotë z. Memushi.

Ai u bën thirrje fermerëve që të shlyejnë detyrimet e tyre për taksën e ujitjes.

“Aktualisht janë bërë mbledhjet e taksave në mënyrë periodike, çdo muaj. Unë u bëj një thirrje që të mos hezitojnë, sepse shërbimin e kanë pasur dhe detyrimin duhet ta derdhin,” shprehet drejtori Memushi.

Falë ndërrhyrjeve dhe investimeve të vazhdueshme ndër vite, ky sistem është mbajtur në gjendje funksionale dhe ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e bujqësisë në zonë.



është bërë e mundur siguri i ujitjes së tokave bujqësore, ndër-

do të jemi aty për ta eliminuar. Zona më problematike është

Bizneset i drejtojnë “gishtin” njëri-tjetrit, në Gjirokastrë kërkojnë kontrolle për çmimet abuzive

Në pazarin karakteristik të Gjirokastrës, një nga zonat më të vizituara të qytetit, disa prej administratorëve të bizneseve kanë shprehur shqetësimin e tyre lidhur me çmimet që po aplikohen nga një pjesë e bizneseve të tjera. Ata theksojnë se pavarësisht rritjes së kostove, kanë zgjedhur të ruajnë çmimet që kanë pasur prej vitesh për të mos cenuar përvojën e vizitorëve dhe për të ruajtur imazhin e qytetit.

“Abuzohet me çmimet, por unë për vete një menu kam pasur qysh para pesë viteve. Shoh që më vijnë turistët edhe për herë të dytë, të tretë. Por një birrë 600 lekë?! E shumta është 100 lekë po ta blesh në treg.”

Administratorët theksojnë se ndihen të penalizuar nga praktikat e padrejta të disa subjekteve të tjera, të cilat sipas tyre abuzojnë me çmimet, duke ndikuar negativisht jo vetëm te

konsumatorët, por edhe te reputacioni i përgjithshëm i pazarit.

“Duhet parë ky problem, sepse është një mundësi e mirë për të rritur fluksin e turistëve.”

“Ata që abuzojnë me çmimet dihet që i bëjnë dëm vetes në radhë të parë, por edhe të gjithëve, sepse lënë një imazh tjetër.”



Bizeset në zonën e pazarit kërkojnë ndërrhyrje nga auto-

ritetet përkatëse dhe propozojnë vendosjen e disa standardeve të përbashkëta për të ruajtur identitetin e pazarit karakteristik të Gjirokastrës.

Sipas tyre, transparenca në çmime dhe respektimi i një niveli të drejtë shërbimi është çelësi për të siguruar një zhvillim të

qëndrueshëm të turizmit dhe mbështetje për bizneset vendase.

Skemat mbështetëse në bujqësi - Fermerët e vlerësojnë ndihmën, kërkojnë pajisjen me dokumente pronësie

Për fermerët, ndihma që po jepet prej vitesh përmes subvencioneve në bujqësi është pozitive dhe i ka ndihmuar ata në zgjerimin e aktivitetit të tyre.

“Është bërë një punë goxha sensibilizuese gjatë kësaj periudhe për nxitjen e sa më shumë fermerëve për t’u bërë pjesë e kësaj skeme, e cila është interesante dhe me përfitime për ta.”

Megjithatë duket se për një pjesë ende mbetet sfidë pajisja me aktin e marrjes së tokës në pronësi, gjë e cila do t’u mundësonte përfitime edhe më të mëdha.

“Na pengojnë letrat e tokës, që hala nuk kanë marrë zgjidhje. Por ky është një problem mbarëkombëtar dhe shumë në disfavor të fermerëve.”

“Aplikimin e kam bërë për 70 dynmë, se më mungon dokumentacioni. Nuk kemi certifikatat pronësie. Edhe atyre që u kemi tokat me qira, disa u mungojnë.”

“Problemi kryesor qëndron te certifikimi i pronës, pra marrja e akteve dhe titujve të pronësisë.”

Në të gjithë vendin, specialistët e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural po zhvillojnë takime informuese me fermerët, me qëllim njohjen e tyre me rregullat dhe mënyrën e përfitimit të granteve

mbështetëse.

Në qarkun Shkodër, skema më e kërkuar vijon të mbetet

ajo e naftës pa akcizë, nga e cila kanë përfituar mbi tre mijë fermerë vitin e shkuar.



Paketa e Maleve gati për zbatim, zëvendësministri: Po kombinohen të gjitha kriteret, zbatimi në vjeshtë

Paketa e Maleve i është afuar zbatimit në terren.

Zëvendësministri i Ekonomisë, Enkelejd Musabelliu, i tha televizionit publik se një ndarje zonale pritet të miratohet së shpejti për ta bërë funksionale skemën.

me një vendim të Këshillit të Ministrave. Në këtë kuadër, të gjithë proceduesve faktikë që gjenden në brendësi të këtyre territoreve u lind e drejta për të aplikuar për të përfituar token me 1 euro për atë sipërfaqe që ata synojnë të zhvil-

shfaqur për zonat në veri të vendit.

“Nga njëra anë, kjo është zona me potencialin më të lartë për zhvillimin e ekonomisë malore. Nga ana tjetër është zona që ka trashëguar që nga vitet ’90 edhe problemet më të mëdha për sa i përket titujve të pronësisë. Ligji u jep mundësinë të gjithë qytetarëve që kanë një lidhje posedimi, pra, qoftë në pikëpamjen e trashëgimisë apo të drejtës zakonore, qoftë edhe në pikëpamjen e posedimit faktik, që të aplikojnë për t’u njohur nga ligji si posedues faktikë,” thotë zv.ministri i Ekonomisë.

Zonat që janë parashikuar të jenë laboratorit i parë i zhvillimit të qëndrueshëm malor pritet të kenë zbatimin e parë në fillim të vjeshtës.

Synimi është që të shfrytëzohet kjo mundësi për ta kthyer malin nga periferia në motor të zhvillimit



“Në këtë moment që flasim, bashkitë janë duke përgatitur zonat me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore, të cilat do të miratohen

lojnë,” tregon z. Musabelliu për RTSH.

Referuar praktikës së deritanishme, sipas zv.ministrit, interesi më i madh është

Fermerët përfitojnë nga Shkollat Fushore të FAO-s për prodhimin në serra

Me një angazhim të qartë për zhvillimin e bujqësisë së qëndrueshme dhe mbështetjen e fermerëve të vegjël, Organizata Botërore e Bujqësisë (FAO) nisi prej 1 korrikut një cikël të ri të Shkollave Fushore për Fermerët (FFS – Farmer Field School) në Lushnjë.

Kjo nismë është pjesë e projektit “Biznesi, Partneritetet dhe Zgjidhjet për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm” (B4SDG II), i cili zbatohet me mbështetjen e Qeverisë së Suedisë.

Trajnimi i parë, i zhvilluar në fshatin Kurtinë, mbledhi së bashku kultivues të primeve në serra, agronomë dhe profesionistë të biznesit bujqësor vendor, me qëllim zgjerimin e njohurive dhe aftësive praktike për përgatitjen e serrave dhe të tokës për transplantim. Ky trajnim shënoi fillimin e një cikli dinamik gjatëmuor trajnimesh që do të zhvillohet nga korriku deri në dhjetor 2025.

“Kjo nismë pasqyron angazhimin e vazhdueshëm të FAO për të punuar krah për krah me fermerët dhe institucionet vendore për të forcuar sistemet ushqimore të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme ndaj ndryshimeve

klimatike në Shqipëri,” u shpreh Lorena Pullumbi, Asistente Përfaqësuese e FAO-s në Shqipëri.

Të organizuara në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë e Lushnjës, këto trajnime nisën me një seancë ndërvepruese të fokusuar në pjellorinë e tokës, teknikat e përgatitjes së saj dhe praktikën e transplantimit, të gjitha të përshtatura me kontekstin vendor të bujqësisë së vogël në serra. Pjesëmarrësit përfituan gjithashtu edhe përvojë praktike në marrjen e mostrave të tokës dhe analizën e tyre, formimin e shtretërve të ngritur dhe teknikat të tjera.

“Qëllimi ynë është të mbështesim fermerët shqiptarë në adoptimin e praktikave të mira bujqësore, përmirësimin e produktivitetit dhe uljen e kostove, duke ndërtuar njëkohësisht qëndrueshmëri ndaj sfidave klimatike,” tha Sara Businaro, Koordinatorë e Projektit të FAO dhe Specialiste e Bujqësisë së Qëndrueshme.

“Përmes këtyre shkollave në fushë, po ofrojmë dije praktike, të përshtatura me kushtet vendore, në mënyrë që



fermerët të mund t’i zbatojnë menjëherë në serrat e tyre”, u shpreh ajo.

Fermerët e vlerësuan këtë risi në mbështetje të tyre për përfitimin e eksperiencave më të mira në fushën e bujqësisë.

Illir Dingozi, fermer serrash nga fshati Kurtinë, tha se, “Prej më shumë se një dekade kultivoj domate në serrën time,

zhvillohen 14 sesione trajnimi një-ditore në dy ferma demonstrimi në Kurtinë/Hysgjokaj dhe Karbunarë, duke synuar sistemet e thjeshta, ashtu edhe ato të përmirësuar të serrave.

Të udhëhequra nga trajnerë me përvojë, temat e trajnimit do të përfshijnë: Menaxhimin e mikroklimës; Kontrollin e dëmtuesve dhe sëmundjeve (praktikat GAP); Ujitjen efikase dhe cilësinë e ujit; Ushqimin e bimëve dhe fertigimin (fertilizimin dhe ujitjen); Përzgjedhjen e fidaneve cilësore dhe shartimin; Modelet e agrobiznesit dhe mundësitë e financimit

Çdo seancë përmbyllet me një rreth reflektimi midis fermerëve, një hapësirë për dialog, mësim nga kolegët dhe shkëmbim përvojash, që zhvillohet në mjediset vendore përreth.

“Këto trajnime jo vetëm që forcojnë aftësitë teknike, por ndihmojnë gjithashtu edhe në krijimin e lidhjeve më të forta

mes institucioneve dhe komunitetit të fermerëve. Është një hap i madh përpara për të ardhmen bujqësore të Lushnjës,” u shpreh Agim Qose, Drejtor i Drejtorisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, Bashkia Lushnje.

Deri në fund të vitit 2025, pritet që këto trajnime të arrijnë një numër të madh fermerësh serrash nga rajoni i Lushnjës, duke i pajisur ata me mjete praktike dhe njohuri për të rritur rendimentin, përmirësuar cilësinë dhe reduktuar ndikimet mjedisore. Përvoja gjithashtu do të shërbejë si një trampolinë për zgjerimin e këtij modeli trajnimi në zinxhirë të tjerë vlere, me një fokus të veçantë në prodhimin e ullinjve dhe vajit të ullirit në vitin 2026.

Nisma B4SDG II në Shqipëri është pjesë integrale e përpjekjeve të FAO për të mbështetur transformimin rural gjithëpërfshirës dhe bujqësinë e qëndrueshme ndaj klimës, duke kontribuar në realizimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) përmes mësimdhënies dhe inovacionit të udhëhequr nga vetë fermerët.

Skema Kombëtare e Investimeve 2025, në Shkodër mbi 200 fermerë të interesuar në javën e parë të aplikimeve

Skema Kombëtare e Investimeve në Bujqësi ka nxitur interesin mes fermerëve të qarkut të Shkodrës deri tani është përqendruar në sektorin e serrave dhe të frutikulturës.



Sipas të dhënave nga drejtoritë vendore të AZHBR-së dhe Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (AREB), vetëm gjatë javës së parë të nisjes së aplikimeve, mbi 200 fermerë janë interesuar për të marrë informacion mbi procedurat dhe kriteret për përfitim nga skema.

“Fermerët kanë interes. Kemi 200 e ca fermerë që kanë shprehur gatishmërinë për të aplikuar këto masa. Interesi duhet të jetë më i madh, sepse favorët në këtë Skemë Investimesh janë më të mëdha se asnjëherë,” shprehet specialisti Sherif Brahaj nga AREB Shkodër.

Nga gjithsej nëntë masa mbështetëse që ofron kjo

skemë për vitin 2025, interesi më i madh i fermerëve të qarkut të Shkodrës deri tani është përqendruar në sektorin e serrave dhe të frutikulturës.



“Interesi më i madh është në përsosjen e mekanizimit të proceseve të punës në bujqësi,



mbjellja e pemëtoreve të reja, ndërtimi i stabilimenteve për

rritjen e shpendëve,” tregon z. Brahaj.

Megjithatë, nisur nga përvoja e viteve të kaluara, një pjesë e madhe e fermerëve të qarkut të Shkodrës mbetet jashtë skemave të subvencionimit për shkak të mosplotësimit të disa prej kriterëve bazë.

“Mungesa e pronësisë mbi tokën, toka e fragmentizuar, sipërfaqet e vogla të tokës, mosbashkimi i fermerëve në shoqata ose grupe fermerësh, këto i penalizojnë shumë fermerë,” thotë specialisti.

Aplikimet për Skemën Kombëtare të Investimeve për këtë vit do të jenë të hapura deri më 30 shtator. Kjo skemë ofron mbështetje financiare në formë grantesh deri në 50% të vlerës së investimit, si dhe kredi të buta me normë interesi vetëm 2% për fermerët,



agropërpunuesit dhe sipërmarrësit e agroturizmit.

Çmimet e vajit të ullirit, drejt rënies? - Prodhuesi më i madh në botë, optimist pas krizës së industrisë

Kompania spanjolle Deoleo, prodhuesi më i madh në botë i vajit të ullirit, thotë se të korrat e bollshme dhe përmirësimi i ndjenjës së tregut tregojnë se industria po rikuperohet nga një prej periudhave më të vështira në historinë e saj.

Një prodhim i bollshëm i ullinjve, veçanërisht në Spanjë, ka ndihmuar në rikthimin e besimit në sektor dhe ka çuar në rënie të ndjeshme të çmimeve për vajin e ullirit në supermarket. Kjo situatë vjen pas dy sezoneve të njëpasnjëshme me prodhim të dobët, që shkaktuan një periudhë të jashtëzakonshme trazirash në të gjithë zinxhirin e furnizimit.

Një "stuhi perfekte" e motit ekstrem të shkaktuar nga ndryshimet klimatike, normave të larta të interesit dhe inflacionit të fortë çoi në një rritje mararamendëse të çmimeve të vajit

vitin e kaluar, një zhvillim që befasoi konsumatorët dhe ekspertët e industrisë.

Megjithatë, burimet zyrtare të kompanisë Deoleo shpjegojnë se tani po ndodh një “ndryshim i madh”. “Ajo që dikur ishte një nga periudhat më sfiduese në historinë tonë, e shënuar nga mungesa e lëndëve të para, luhatje të forta çmimesh dhe rënie të konsumit, tani po i lë vend një tregu më të qëndrueshëm dhe premtues,” thonë ata.

Deoleo pret që një ambient me çmime më të kontrolluara për lëndët e para të vazhdojë edhe gjatë gjysmës së dytë të vitit 2025. “Rritja e ndjeshme e prodhimit të vajit të ullirit, veçanërisht në Spanjë, tashmë po sjell një furnizim më të qëndrueshëm dhe kjo ka ndikim të drejtpërdrejtë në çmimet,” shtojnë burimet.

Shumica e prodhimit glob-

al të vajit të ullirit vjen nga vendet e Mesdheut, me shtete si Spanja, Italia dhe Greqia që janë ndër prodhuesit më të mëdhenj në botë. Spanja, në veçanti, është prodhuesi më i madh në Bashkimin Evropian dhe një pikë referimi globale për çmimet në këtë sektor.

Sipas Ministrisë së Bujqësisë, Peshkimit dhe Ushqimit të Spanjës, vendi prodhoi 1.41 milionë tonë vaj ulliri gjatë sezonit bujqësor 2024/2025. Kjo sasi, ndonëse pak më e ulët se sa ishte parashikuar, përfaqëson një rritje prej rreth 65% krahasuar me 855,600 tonë një vit më parë.

Deoleo theksoi se të korrat rekord në Spanjë kanë shkaktuar një rënie prej 50% të çmimeve të lëndëve të para, ka nxitur kërkesën dhe i ka mundësuar kompanisë të ulë çmimet e vajit të ullirit në raftet e dyqaneve.





SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI E SHPEJTË MIKRO

PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



LEGJISLACION

Pensionet, nis zbatimi i njohjes së periudhave kontributive automatikisht - Udhëzimi për ata që s'kanë marrë pension. Aplikimi, formulari e dokumentet

Pas miratimit të ligjit të ri 7/2025, i cili mundëson njohjen e periudhave të punës në institucionet shtetërore, ish-ndërmarrjet shtetërore, ish-ndërmarrjet bujqësore dhe ish-kooperativat bujqësore si vite sigurimi për efekt pensioni, Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka nisur zbatimin. Vitet e punës të kryera përpara vitit 1991 do të njihen automatikisht si periudha sigurimi, pa qenë nevoja që qytetarët të përballen me gjykata, padi apo pengesa burokratike që kanë rënduar shpesh mbi ta.

Ky ndryshim prek drejtpërdrejt mijëra qytetarë që kanë kontribuar në ekonominë shtetërore, në kooperativat bujqësore apo në ndërmarrjet e asaj kohe, por që për shkak të mungesës së dokumentacionit ose procedurave, kanë mbetur jashtë skemës së drejtë të përfuturimit të pensionit. Ky ligj synon të përfshijë një kategori

të gjerë qytetarësh që kanë kontribuar, por nuk kanë përfutur pension të plotë për shkak të mungesës së dokumentacionit.

PROCEDURA

Nuk ka asnjë tarifë, aplikimi është falas.

Kohëzgjatja e shqyrtimit është 1-2 muaj, në varësi të verifikimeve.

Nëse kërkesa pranohet, pensioni përlogaritet nga data e dorëzimit të aplikimit.

Nuk nevojitet gjyq, edhe nëse më parë është kërkuar me padi.

Ky ligj është një hap i rëndësishëm drejt drejtësisë sociale për mijëra qytetarë që



meritojnë një pension të denjë për kontributin e tyre ndër vite. Për herë të parë, aplikimi për

këtë njohje mund të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë pranë zyrës së Sigurimeve Shoqërore

të vendbanimit, ku çdo qytetar ndihmohet për të plotësuar kërkesën dhe për të dorëzuar një set të thjeshtuar dokumentesh.

Formulari i aplikimit plotësohet në zyrë, me ndihmën e specialistit të ISSH-së dhe përfshin të dhënat personale të aplikuesit, si dhe një deklaratë të vetëdijshme që ai ose ajo nuk ka qenë i dënuar me vendim gjykatë gjatë periudhës së pretenduar të punës.

DOKUMENTACIONI QË KËRKOHET:

Kartë identiteti ose pasaportë e vlefshme

Vërtetimi i vendbanimit historik, dokument i cili merret në zyrën e gjendjes civile dhe tregon që gjatë viteve përkatëse ka punuar në atë qytet apo fshat.

Nëse nuk gjendet vërtetimi i asaj kohe, mund të përdoret edhe një deklaratë noteriale nga të afërm ose dëshmitarë.

Libreza e punës ose vërtetime pune (nëse ekzistojnë). Edhe nëse keni vetëm pjesë të fragmentuara të saj. Në mungesë, ISSH e verifikon vetë, bazuar në të dhënat nga ish-ndërmarrjet Shtetërore, Komunitat ose Arkivat.

Deklaratë personale që nuk jeni dënuar me vendim gjykatë (Kjo deklaratë bëhet me shkrim në zyrën e ISSH, bashkë me formularin).

Në raste të caktuara, vërtetimi që aplikimi është në proces gjyqësor ose administrativ (nëse po kërkonte rishikim të vendimit të mëparshëm).

LIGJI 7/ 2025

PËR NJOHJEN E PERIUDHAVE TË PUNËSIMIT NË ISH-INSTITUCIONET SHTETËRORE, NË ISH-NDËRMARRJET SHTETËRORE, NË ISH-NDËRMARRJET BUJQËSORE DHE NË ISH-KOOPERATIVAT BUJQËSORE PËR EFEKT PENSIONI NË SISTEMIN E SIGURIMEVE SHOQËRORE

www.iss.gov.al

CILAT PERIUDHAT PUNE NJIHEN?

◆ **1. Në ish-institucionet shtetërore dhe ish-ndërmarrjet shtetërore:**
 · Nga moshë 18 vjeç, deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7703, datë 01.10.1993
 · Nga përfundimi i shkollës së lartë deri në datën e mësipërme, me kusht që gjatë kësaj periudhe :
 ■ Të keni qenë me banim në qytet
 ■ Të mos keni qenë duke vuajtur dënimin me heqje lirie

◆ **2. Në ish-ndërmarrjet bujqësore:**
 · Nga moshë 18 vjeç, por jo më herët se data e krijimit të ndërmarrjes, deri më datë 17.10.1992, me kusht që gjatë kësaj periudhe :
 ■ Të keni qenë me banim në zonën ku shtrinte aktivitetin ndërmarrja
 ■ Të mos keni qenë duke vuajtur dënimin me heqje lirie

◆ **3. Në ish-kooperativat bujqësore :**
 · Nga moshë 18 vjeç, deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, me kusht që gjatë kësaj periudhe :
 ■ Të keni qenë me banim në fshatin ku shtrinte aktivitetin kooperativa
 ■ Të mos keni qenë duke vuajtur dënimin me heqje lirie

KUSH PËRFITON?

➔ **PERSONAT, TË CILËVE DERI NË DATËN E HYRJES NË FUQI TË LIGJIT, NUK JU ËSHTË CAKTUAR ENDE NJË PENSION, PAVARËSISHT DATËS SË PLOTËSIMIT TË MOSHËS APO TË KRITEREVE LIGJORE PËR PENSIONET E TJERA QË ADMINISTRON ISSH**

➔ **PERSONAT, TË CILËT NË DATËN E HYRJES NË FUQI TË KËTIJ LIGJI, ISHIN NË PROCEDURË ADMINISTRATIVE APO GJYQËSORE PËR NJOHJEN E PERIUDHAVE TË PUNËS**

➔ **PERSONAT, TË CILËT PARAQESIN KËRKESË PËR RISHQYRTIM PENSIONI, PAS DATËS SË HYRJES NË FUQI TË KËTIJ LIGJI, POR BRENDË NJË VITI NGA DATA E LINDJES TË SË DREJTËS**

www.iss.gov.al

Shqipëria, 16 marrëveshje për njohjen e pensioneve - Bashkëpunim institucional për sigurimet shoqërore

Shqipëria ka nënshkruar dhe tashmë zbaton marrëveshje dypalëshe për sigurimet shoqërore me 16 shtete të ndryshme, duke garantuar mbrojtje dhe përfitime për qytetarët që kanë punuar në më shumë se një vend.

Këto marrëveshje ndihmojnë në ruajtjen e të drejtave për pension dhe përfitime të tjera për personat e siguruar që kanë lëvizur mes Shqipërisë dhe vendeve të tjera, duke siguruar që asnjë periudhë kontributive të mos humbasë dhe që pensionet të përfutrohen nga të dyja sistemet përkatëse.

Ato bazohen në parime të përbashkëta, si trajtimi i barabartë i qytetarëve, përcaktimi i qartë i vendit përgjegjës për sigurimin, ruajtja e të drejtave të fituara, eksportimi i përfitimeve dhe bashkëpunimi ad-

ministrativ mes institucioneve të vendeve përkatëse.

Aktualisht, këto marrëveshje zbatohen me Turqinë që nga viti 2005, me Belgjikën që nga janari i vitit 2016, Luksemburgun dhe Maqedoninë e Veriut nga mesi i vitit 2016, Hungarinë nga korriku i po atij viti, me Republikën Çeke nga shkurt

2017, Gjermaninë nga dhjetor 2017 dhe Austrinë nga fundi i vitit 2018. Në vitet e fundit janë shtuar edhe marrëveshjet me Kosovën, Kanadanë, Zvicrën, Kroacinë, Bullgarinë dhe Rumaninë, ndërsa në vitin 2025 hyjnë në fuqi edhe marrëveshjet me Malin e Zi dhe Italinë.

Kjo e fundit është dhe më e rëndësishmja për shkak se përfutet të kësaj marrëveshjeje priten të jenë rreth 500 mijë shqiptarë, duke qenë dhe ndër ku ka qenë më shumë e fokusuar emigracioni i të rinjve shqiptarë deri vite. Këto marrëveshje janë një garanci për të gjithë ata që kanë punuar e kontribuar në sistemet e sigurimeve shoqërore brenda dhe jashtë vendit, duke u mundësuar atyre që të mos humbin përfitimet e fituara me vite pune.



Rrugë të reja në Alpet e Shqipërisë - Lidhet kontrata 3.63 mln euro, përmirësim i aksesit dhe infrastrukturës së turizmit të aventurës

Përmirësimi i aksesueshmërisë dhe infrastrukturës së turizmit të aventurës në Alpet e Shqipërisë". Ky është investimi që parashikohet të kryhet në veri të vendit, me fokus ndërhyrjet në rrugë në një nga zonat me potencial turistik në vend.

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ka lidhur kontratën me vlerë prej rreth 3.63 mln euro me bashkimin e operatorëve BE -IS dhe Ergi shpk, që do të kryejë punimet në terren. Sipas të dhënave afati i përfundimit të punimeve është janari i vitit 2027.

Ndërhyrjet në këtë aks rrugor janë pjesë e projektit për Infrastruktura dhe Turizmin në Shqipëri, që finan-

cohet nga Bashkimi Evropian nëpërmjet asistencës teknike dhe granteve të investimeve në një shumë totale prej 40 milionë euro, si dhe nga kredia sovranë plotësuese 60 mln euro e dhënë nga BERZH për qeverinë shqiptare. Projekti zbatohet nga Fondi Shqiptar



i Zhvillimit, teksa më herët janë lidhur edhe kontrata të tjera të ngjashme.

Një prej tyre është kontrata me vlerë 1.52 mln euro për rehabilitimin e segmentit rrugor nga rrethrotullimi i Sop-it deri në Urën e Darzezës. Rruga ndodhet në zonën e Semanit dhe fillon në kryqëzimin me Rrugën Kombëtare Fier - Vlorë, rrethi Apollonia, vazhdon përgjatë segmentit rrugor Hoxharë dhe përfundon në Urën e re të Darzezës.

Paralelisht, në kuadër të këtij programi BERZH ka zhvilluar edhe tenderë për përmirësimin e rrjetit elektrik në Alpet e Shqipërisë, duke synuar rritjen e aksesit në energji elektrike në këtë zonë.

Fatos Çoçoli: T'i besojmë skemës së investimeve në bujqësi?

Për herë të parë, investimet në bujqësi marrin një fond rekord nga shteti prej 20 milionë euro në vit. Kredia e butë kombinohet me grant, para falas nga shteti për 50 përqind të investimit

Nga data 30 korrik 2025, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka hapur aplikimet për Skemën Kombëtare të Investimeve 2025 në bujqësi.

Për herë të parë, skema ka në dispozicion në dy muajt gusht-shtator këtë vit, një fond rekord prej 20 milionë euro nga Buxheti i Shtetit, në mbështetje të fermerëve dhe bizneseve bujqësore.

Skema përfshin kredi të buta dhe grante investimi, të ndara në nëntë masa mbështetëse, që synojnë rritjen e prodhimit bujqesor e blegtoral, përmirësimin e teknologjisë dhe forcimin e qëndrueshmërisë.

<i>Tabela 1. Nëntë masat e Skemës Kombëtare të Investimeve 2025</i>
· Ndërtimi i serrave diellore të reja për prodhimin e perimeve, luleshtrydheve dhe rrushit të tavolinës
· Mbjellje të reja në pemë frutore, ullinj, agrume dhe vreshta
· Rrjeta antibreshër për pemët, agrumet dhe vreshtat ekzistuese
· Sistemet e ujitjes me pika në pemëtore dhe vreshta
· Ndërtimi i ambienteve për mbarështimin e blegtorisë dhe shpendarisë
· Mekanizimi dhe modernizimi i fermave bujqësore dhe blegtorale
· Pajisjet për përpunim dhe paketim për perime, fruta, rrush, verë, ullinj dhe vaj ulliri
· Investime në agroturizëm
· Koshat dhe rrjetat e peshkimit për akuakulturë

Mundësi të reja për fermerët dhe agropërpunuesit

Janë me mijëra fermerët dhe shoqatat e tyre si shoqëri biznesi me status fizik ose juridik, të cilët mund dhe po aplikojnë për ndihmë financiare per nente masat e Skemes, nëpërmjet agropikave(zyra rajonale për dhënie informacioni) ose agjencive rajonale të ekstensionit (shërbimit) bujqësor në zonën e tyre.

<i>Tabela 2. Objektivat kryesore të Skemës</i>
· Rritja e prodhimit bujqësor, duke nxitur mekanizimin dhe teknologjitë moderne
· Rritja e ndjeshme e investimeve private në bujqësi
· Sigurimi i cilësisë dhe standardeve, në përputhje me kërkesat e BE-së (standartet HACCP, Global G.A.P., etj.)
· Zhvillimi rural i qëndrueshëm përmes diversifikimit të aktiviteteve ekonomike në zonat rurale
· Rritja e eksportit të produkteve të përpunuara bujqësore
· Ulja e varësisë nga importet bujqësore.

Skema Kombëtare e Investimeve në bujqësi 2025 ka hapur mundësi të reja për fermerët, agropërpunuesit dhe sipërmarrësit e sektorit të agroturizmit. Kjo iniciativë, e cila është e hapur për aplikime deri më 30 shtator 2025, ofron një paketë mbështetjeje financiare të integruar, që përfshin grante deri në 50% të vlerës së investimeve, si dhe kredi të buta me normë të ulët interesi deri 2 përqind në vit, mbuluar me garanci shtetërore deri në 70 përqind të vlerës së kredisë.

<i>Tabela 3. Përfituesit nga Skema</i>
- Fermerë individualë ose familjar.
-Shoqëri tregtare që veprojnë në fushën e bujqësisë dhe agropërpunimi.
- Shoqata prodhuesish bujqësorë
- Start-up-e bujqësore dhe agroturistike.

Orientimi i ri i politikës sonë bujqësore

Me këto masa të realizuara, politika bujqësore e Shqipërisë është orientuar drejt mbështetjes së investimeve të qëndrueshme në sektorin agro-ushqimor, me synim rritjen e prodhimit vendas, përmirësimin e cilësisë së produkteve, si dhe fuqizimin e konkurrueshmërisë në tregjet e brendshme dhe të jashtme. Nga ana tjetër, me këto 20 milionë euro mbështetet ndjeshëm edhe agroturizmi, i cili ndihmon në zgjimin e interesit të të rinjve për të qëndruar në fshat, në ruajtjen e traditave dhe promovimin e produkteve autentike shqiptare.

Skema ndihmon edhe promovimin e farës autoktone shqiptare, trashëgiminë në kuzhinën tonë karakteristike dhe mbështet edhe programin “Paketa e Maleve”, një nismë që deri tani ka marrë mbi 2500 aplikime.

Skema gjithashtu i jep mundësinë çdo aplikanti të përfitojë nga më shumë se një masë mbështetjeje, pa kufizime monetare, duke lejuar kombinimin e



investimeve në mbjellje të reja, me investime në teknologji dhe mbrojtjen e prodhimeve.

Me këtë skemë, vetëm subvencionet për sektorin e bujqësisë kapin për këtë vit vlerën e 45 milionë eurove, ndërsa në qershor 2025 Ministria e Financave dha garancinë 3 miliardë lekë ose mbi 30 milionë euro për huatë e buta në bujqësi.

Tetë dobitë e Skemës Kombëtare të Investimeve 2025 në bujqësi

Skema Kombëtare e Investimeve për bujqësinë në vitin 2025 synon të ofrojë mbështetje të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershme për fermerët dhe agropërpunuesit shqiptarë. Kjo skemë e financuar nga buxheti i shtetit ka disa përfitime të dukshme, që ndikojnë si në rritjen e prodhimit dhe cilësisë së produkteve bujqësore, ashtu edhe në zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale.

1. Rritja e investimeve të menjëhershme në sektor

Mbështetja financiare nga skema u mundëson fermerëve dhe bizneseve rurale të realizojnë shpejt projekte të blerjes së pajisjeve, ndërtimit të infrastrukturës dhe zgjerimit të kapaciteteve prodhuese, pa pritur procedurat e gjata të fondeve ndërkombëtare.

2. Mbështetje më e gjerë për fermerët e vegjël

Skema kombëtare është projektuar të jetë më e aksesueshme, me kritere më të thjeshta për aplikim. Kjo lehtëson pjesëmarrjen e fermerëve të vegjël dhe atyre me kapacitete të kufizuara administrative, të cilët shpesh kanë vështirësi të përfitojnë nga programe të tjera.

3. Përmirësimi i infrastrukturës bujqësore

Përmes fondeve të skemës, financohen sisteme moderne ujitjeje, sera të mbyllura, magazina ruajtjeje, pika grumbullimi dhe linja përpunimi, duke rritur cilësinë dhe jetëgjatësinë e produkteve.

4. Nxitja e mekanizimit dhe teknologjisë

Skema ofron mbështetje për blerjen e makinerive dhe pajisjeve të reja, çka ul kos-ton e prodhimit, kursen kohë dhe rrit efikasitetin e punës.

5. Rritja e sigurisë ushqimore

Duke financuar investime në përpunim dhe paketim, skema ndihmon prodhuesit të përmbushin standartet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë ushqimore, duke rritur besimin e konsumatorëve dhe aksesin në tregjet e huaja.

6. Ulja e varësisë nga importet

Mbështetja për prodhimin vendas rrit ofertën e produkteve bujqësore dhe përpunu-ara në tregun e brendshëm, duke zvogëluar nevojën për importe dhe duke ruajtur bilancin tregtar.

7. Nxitja e punësimit në zonat rurale

Investimet e reja krijojnë vende pune të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, duke frenuar emigracionin dhe duke gjallëruar ekonominë lokale.

8. Rritja e konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare

Prodhuesit e mbështetur nga skema kanë mundësi të përmirësojnë cilësinë, sasinë dhe prezantimin e produkteve, duke fituar pozita më të mira në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare.

INTERVISTA

“Banka e re Ziraat do të rrisë konkurrencën në treg” - Zefi: Qytetarët do të përfitojnë nga produkte të reja dhe ulje të normave të interesit

Pas vitesh të tëra konso- lidimi, tregu bankar pritet të pësojë tashmë ndryshime të rëndësishme me dhënien nga ana e Bankës Qendrore, të miratimit paraprak për licencimin e Ziraat Bank. Ziraat, duhet të përmbushë edhe disa kushte të tjera përpara se të hapet zyrtarisht për të ofruar produktet e saj për qytetarët dhe bizneset shqiptare.

Sipas pedagogut Altin Zefi, futja e një aktori të ri në treg do të rrisë edhe më tej konkurrencën, e cila mund të përkthehet në uljen e çmimeve të produkteve, si në rastin e normave të interesit.

“Mund të ndikojë në rritjen e konkurrencës dhe të detyrojë bankat e tjera që të ulin normat e interesit, të ofrojnë produkte të reja për huamarrësin dhe gjithashtu të investojnë në teknologji të reja, të përmirësojnë operacionet, të ulin kostot operacionale në mënyrë që të rrisin efikasitetin. Pra, mund të krijojë përfitime direkte për qytetarët dhe bizneset e vogla me uljen e kostove të huamarrjes”, nënvizoi Zefi.

Duke qenë një bankë e specializuar për financim në bujqësi, me futjen në tregun shqiptar, Ziraat Bank pritet të përballet edhe me disa sfida të cilat lidhen me nivelin e lartë të informalitetit në bujqësi dhe mungesën e kolateralit nga bujqit.

“Banka Ziraat duhet të njihet me tregun shqiptar

dhe duhet të përshtatet me tregun shqiptar, me sfidat, të cilat mund të jenë sfida strukturore, sfidat e informalitetit, mungesa e hipotekave për tokat bujqësore, aftësia pra për të lënë kolateral nga bujqit është në nivel të ulët dhe si e tillë, ata duhet të përshtatin produktet e tyre. Gjithashtu, duhet marrë parasysh që Banka Ziraat ka njoftuar se nuk do të fokusohet vetëm në bujqësi, kështu që do të shohim se si do të operojë, se sa përqind e aseteve të saj dhe investimit të saj do të shkojë për zhvillimin bujqësor”, tha pedagogu.

Zefi u shpreh ndër të tjera se rritja e financimit dhe e kreditimit, do të nxisë rritjen afatgjatë ekonomike.

Intervista e plotë me Pedagogun Altin Zefi

“Hyrja e një banke si Ziraat, pas 19 vitesh siç e përmendët edhe ju, mund të ketë implikime të rëndësishme. Sipas teorisë së konkurrencës, shtimi i një aktori të rëndësishëm në treg, siç është Banka Ziraat, mund të ndikojë në rritjen e konkurrencës, mund të ndikojë në çmimet

e produkteve siç janë normat e interesit, pra mund të krijojë përfitime direkte



për qytetarët dhe bizneset e vogla me uljen e kostove të huamarrjes. Gjithashtu, ka implikime edhe për tregun bankar. Duke qenë se një bankë e tillë me një përvojë shumë të gjatë, më shumë se 100 vite mund të themi në tregun bankar dhe sidomos me ndikimin e saj në bujqësi dhe me financimet në bujqësi, mund të ndikojë në rritjen e konkurrencës dhe të detyrojë bankat e tjera që të ulin normat e interesit, të ofrojnë produkte të reja për huamarrësin dhe gjithashtu të investojnë në teknologji të reja, të përmirësojnë operacionet, të ulin kostot op-

eracionale në mënyrë që të rrisin efikasitetin. Pra, mund të krijojë një dinamizëm të

hënie.

Megjithatë, pritet të ketë ndikim pozitiv në përgjithësi në ekonomi. Sigurisht që Shqipëria është një vend me një nivel kreditimi shumë të ulët në rajon, krahasuar me rajonin, për sa i përket krahasimit me GDP-në, jemi rreth 35% e kreditimit në ekonomi, dhe bujqësia sidomos, një nga sektorët strategjikë të Shqipërisë zë një përqindje shumë të vogël në krahasim me rajonin.

Teoria ekonomike thotë që me rritjen e financave, pra me rritjen e financimit dhe produkteve të reja nga një bankë e specializuar në këtë fushë, mund të ketë përfitime direkte dhe të shpejta për huamarrësin, sidomos për familjarët dhe bizneset e vogla në bujqësi. Bujqësia, siç e përmenda më herët është një nga sektorët strategjikë, 18% e GDP, e Produktit të Brendshëm Bruto të Shqipërisë e ka origjinën nga bujqësia dhe rreth 1/3 e të punësuarve janë të punësuar në bujqësi, pra një sektor tepër i rëndësishëm për Shqipërinë, por me financim minimal, rreth 1.7% ose poshtë nivelit të 2% është disproporcional krahasuar me të gjitha ven-

det e tjera. Duke qenë sektor aq i rëndësishëm, rritja e financimit dhe produktet e reja që Ziraat mund të ofrojë për tregun bankar shqiptar dhe ekonominë shqiptare, do të nxisin rritjen ekonomike, pra rritja e financimit dhe rritja e kreditimit është e lidhur, sipas shumë studimeve, direkt me rritjen afatgjatë ekonomike.

Megjithatë, kjo ka rreziqet dhe sfidat e saj. Banka Ziraat duhet të njihet me tregun shqiptar dhe duhet të përshtatet me tregun shqiptar, me sfidat, të cilat mund të jenë sfida strukturore, sfidat e informalitetit, mungesa e hipotekave për tokat bujqësore, aftësia pra për të lënë kolateral nga bujqit është në nivel të ulët dhe si e tillë, ata duhet të përshtatin produktet e tyre me tregun shqiptar. Gjithashtu, duhet marrë parasysh që Banka Ziraat ka njoftuar se nuk do të fokusohet vetëm në bujqësi, kështu që do të shohim se si do të operojë, se sa përqind e aseteve të saj dhe investimit të saj do të shkojë për zhvillimin bujqësor, por që bujqësia shqiptare do të jetë ajo që do të përfitojë më shumë. Do të jetë një përfitim i rëndësishëm, sepse niveli tashmë është tepër i ulët dhe specializimi i Bankës Ziraat në investimet në bujqësi do të përbëjë një faktor të rëndësishëm për zhvillimin e këtij sektori strategjik për Shqipërinë.”

“Mbushen” fuçitë e verës në Francë - Prodhimi rikthehet në rritje pas një viti të vështirë

Prodhimi i verës në Francë pritet të rikthehet me rritje prej të paktën 10% këtë vit, pas një niveli të ulët në vitin 2024 për shkak të kushteve të pafavorshme të motit. Megjithatë, rikuperimi do të kufizohet nga humbja e disa vreshtave në jugperëndim të Francës, si pjesë e një programi të ristrukturimit të industrisë.

Franca, që konkurron me Italinë dhe Spanjën për pozicionin e prodhuesit më të madh të verës në botë, pritet të prodhojë mes 40 deri 42.5 milionë hektolitra këtë vit, që përfaqëson një rritje prej 10%-17% krahasuar me vitin 2024, tha ministria në parashikimin fillestar për 2025.

Shkalla e parashikuar e prodhimit është pak më poshtë se mesatarja prej 42.9 milion hektolitrash e pesë viteve të fundit. Një hektolitër është ekuivalent me rreth 133 shishe standarde vere.

“Në vitin 2025, kushtet e motit kanë qenë më të favorshme. Fillimi i thatë dhe i nxehtë i verës ndihmoi në uljen

e presionit të sëmundjeve,” tha ministria në një raport, duke shtuar se vjelja e rrushit mund të fillojë më herët se zakonisht në shumë rajone.

Vitin e kaluar, shirat e

jugperëndimore, rikuperimi do të jetë i kufizuar nga humbja e disa vreshtave, me mbi 20,000 hektarë të hequr që nga viti 2024.

Qeveria ka subvencionuar



stuhishëm dëmtuan vreshtat si edhe tokat e tjera bujqësore, ndërsa kushtet e lagështa favorizuan përhapjen e sëmundjeve. Rritja në prodhim e këtij viti mund të jetë veçanërisht e fortë në rajonet Bourgogne, Champagne, Luginën e Luarës dhe Charentes. Por në zonat

heqjen e vreshtave për të përballuar tepricën e prodhimit përballë rënies së konsumit të verës. Kjo qasje është kritikuar nga disa prodhues, për shkak se i bën zonat jugore më të ndjeshme ndaj zjarreve, siç ndodhi me flakët e mëdha në rajonin Aude këtë javë.

Skema kombëtare e investimeve, fermerët e Kukësit aplikojnë kryesisht për ndërtimin e stallave

Prej datës 30 korrik janë hapur aplikimet për Skemën

të vendgrumbullimit të ujit”, tha Peposhi.



Kombëtare të Investimeve 2025, një paketë e re financimi me 20 milionë euro në mbështetje të fermerëve dhe bizneseve bujqësore.

Bajram Peposhi, përgjegjës i shërbimit veterinar tha se në qarkun e Kukësit ka patur kërkesa dhe aplikime më së shumti për stalla.

“Më shumë kemi kërkesa për stalla dhe jo aq për sektorin e agro-përpunimit. Kemi kërkesa për riparimin e lera-



Prej vitesh, mungesa e certifikatës së pronësisë mbetet pengesë në procesin e aplikimit të fermerëve.

“Ka pas aplikime, por do shohim si do ecim me problemin e certifikatës së pronësisë së tokës pasi penalizon fermerët”, tha ai.

Programi i financimeve në fushën e bujqësisë ofron një mundësi reale për të zgjeruar kapacitetet prodhuese të fermerëve, për të promovuar risitë në këtë sektor dhe për të siguruar të ardhura më të larta për komunitetet rurale.

Pamja e qiellit gjatë muajit shtator 2025

Më 7 shtator - Hëna e plotë. Hëna do të jetë e vendosur në anën e kundërt të Tokës me

Parashikimi i motit për muajin shtator 2025 në Tiranë (Zona bregdetare)

Dt.	Temperatura e ajrit °C		Temp. reale që ndjehet °C	Shiu		Era				UV Indeks	Përshkrimi i shkurtër i motit	Simboli
	U	L		mm	Orë	Km/Orë		Drejtimi				
						D	N	D	N			
1	18	27	18-31-26	0	0	7	6	VL	V	7	Diell deri pjesërisht me re	
2	18	28	18-27-27	0	0	7	6	VL	VVP	2	Vranësiërë	
3	19	28	18-31-26	0	0	6	6	VL	V	6	Kryesisht me diell	
4	18	27	18-30-26	0	0	7	6	VL	V	6	Kryesisht me diell	
5	19	27	19-30-26	0	0	7	6	VL	V	6	Diell	
6	20	28	20-31-27	0	0	6	6	VL	L	6	Kryesisht me diell	
7	20	29	20-32-28	0	0	6	6	VL	L	6	Kryesisht me diell	
8	21	30	21-33-29	0	0	6	6	VL	VVP	6	Plot me diell	
9	20	30	22-34-30	0	0	6	6	VVL	V	6	Kryesisht me diell	
10	21	30	21-33-29	0	0	6	7	VL	VVP	6	Pjesërisht me diell	
11	20	30	19-33-29	0	0	6	7	VL	V	6	Diell	
12	18	28	16-28-26	7.9	5	17	11	JJP	JJP	5	Re dhe diell me disa reshje shiu dhe stuhi, kryesisht në fillim të ditës	
13	20	27	18-29-26	1	1	6	13	PJP	LJL	5	Një stuhi me pika në mëngjes;pastaj pjesërisht me diell	
14	19	29	17-30-29	1	1	11	7	J	VL	5	Pjesërisht me diell me stuhi me pika pas dite	
15	18	27	17-28-26	2.2	2	11	13	VVL	VL	5	Pjesërisht me diell me disa shira dhe stuhi kryesisht pasdite	
16	18	27	17-28-25	0	0	9	7	VVL	VVL	5	Kryesisht me diell	
17	20	27	19-30-26	0	0	4	6	J	LVL	5	Diell dhe pak re	
18	20	27	18-27-27	3.4	5	9	9	JJL	JL	3	Kryesisht vranësiërë, një shi me pika në mëngjes i ndjekur nga periudhë me shira pasdite	
19	19	31	17-31-29	0	0	13	20	JJP	J	5	Shumë ngrohtë me plot diell	
20	19	29	18-29-28	3.1	2	20	11	JP	JJP	5	Kohë me re dhe diell me disa stuhi, herët në mëngjes	
21	18	28	14-27-26	8.5	3	24	30	JJP	J	5	Pjesërisht me diell	
22	17	26	16-25-25	11.8	7	20	6	JJP	JL	2	Vranësiërë dhe stuhi	
23	16	26	14-26-25	3.3	2.5	13	9	P	VVL	5	Vranësiërë dhe diell; disa stuhi në mëngjes pastaj disa shira pasdite	
24	15	26	16-26-24	3	4	13	9	VP	VVL	6	Re dhe diell me disa shira,kryesisht herët në mëngjes	
25	14	25	15-25-25	0.3	1	11	9	VP	VVP	6	Pjesërisht me diell	
26	17	25	17-25-25	0	0	8	10	JL	L	7	Kohë me diell	
27	16	25	16-26-26	5.5	5	6	9	JJL	VP	6	Kryesisht me diell	
28	16	25	16-25-24	3.3	4	10	11	JJP	JL	6	Vranësiërë dhe shira me stuhi	
29	17	25	17-26-25	0.2	1	7	9	J	LVL	6	Kryesisht me diell	
30	17	28	17-28-25	0	0	6	9	JL	JJL	6	Kohë me diell	

Diellin dhe faqja e saj do të jetë plotësisht e ndriçuar. Kjo fazë do të ndodhë në orën 20:08 UTC. Kjo hënë e plotë njihej nga fiset e hershme amerikane vendase si Hëna e Misrit sepse misri kor-ret rreth kësaj kohe të vitit. Kjo hënë njihet edhe si Hëna e Kor-rjes. Hëna e Korrrjes është hëna e plotë që ndodh më afër ekuinok-sit të shtatorit çdo vit.

Më 7 shtator - Eklips total hënor. Një eklips total hënor ndodh kur Hëna kalon plotë-sisht nëpër hijen e errët të Tokës, ose umbra. Gjatë këtij lloji eklipsi, Hëna gradualisht do të errësohet dhe pastaj do të marrë një ngjyrë të kuqe të ndryshkur ose të kuqe gjaku. Eklipsi do të jetë i dukshëm në të gjithë Azinë dhe Australinë dhe pjesët qendrore dhe lindore të Evropës dhe Afrikës.


Më 21 shtator - Hëna e re. Hëna do të jetë e vendo-sur në të njëjtën anë të Tokës me Diellin dhe nuk do të jetë e dukshme në qiellin e natës. Kjo fazë do tëndodhë në orën 21:54 UTC. Kjo është koha më e mirë e muajit për të vëzhguar objekte të zbehta si galaktikat dhe grumbujt yjorë, sepse nuk ka dritë hëne që të ndërhyjë.

Më 21 shtator - Eklips i pjesshëm diellor. Një eklips i pjesshëm diellor ndodh kur Hëna mbulon vetëm një pjesë të Diellit, ndonjëherë i ngjan një kafshimi të marrë nga një biskotë. Një eklips i pjesshëm diellor mund të vëzhgohet në mënyrë të sigurt vetëm me një filtër të veçantë diellor ose duke parë reflektimin e Diellit.

Ky eklips i pjesshëm do të jetë i dukshëm vetëm në Zelandën e Re, Antarktidë dhe Oqeanin Paqësor jugor.

Treguesit mesatarë klimatikë gjatë muajit shtator 2025

Treguesit	Tiranë	Korçë	Vlorë	Shkodër	Dibër	Gjirokastrë
Temperatura e ajrit						
Mesatare (°C)	24	20	25	24	16	21
Maksimale (°C)	28	24	26	28	22	26
Minimale (°C)	21	16	23	20	10	17
Më e larta gjatë viteve (°C)	35 (2020)	32 (2021)	33 (2015)	37 (2011)	31 (2021)	34 (2011)
Më e ulta gjatë viteve (°C)	11 (2018)	4 (2018)	15 (2018)	11 (2012)	-2 (2012)	6 (2018)
Numuri i ditëve me Temperaturë + 30°C (Ditë dhe %)	7 (23)	2 (7)	3 (10)	10 (33)	0 (0)	3 (10)
Numuri i ditëve me Temperat në + 18°C (Ditë dhe %)	30 (100)	27 (90)	30 (100)	30 (100)	24 (80)	30 (100)
Era						
Shpejtësia e erës (Km/Orë)	14	11	18	12	10	11
Temperatura e erës (°C)	21	16	23	20	10	16
Reshjet (Shiu)						
Shi (mm)	134	116	123	118	133	151
Numuri i ditëve me shi (Ditë dhe %)	7 (22)	7 (22)	5 (18)	4 (14)	8 (27)	7 (22)
Sasia rekord e shiut gjatë një dite (mm dhe viti)	102.6 (2015)	73.6 (2010)	93.3 (2012)	160.9 (2013)	67.3 (2011)	128.2 (2011)
Lagështia e ajrit (%)	65	73	65	62	74	66
Shikueshmëria (Km)	9.61	9.26	9.68	9.65	9.16	9.53
Mbulimi i qiellit me re (%)	19	26	17	19	27	20
UV index	6	5	7	7	5	6
Orë me diell nëDitë	12	12	12	12	12	12
Gjatësia e ditës (Orë)	12:29	12:28	12:28	12:30	12:29	12:27
Vlerësimi i muajit	Mirë	Mirë	Mirë	Shumë	Mirë	Mirë



Më 21 shtator - Saturni në Opozita. Planeti me unaza do të jetë në afrimin e tij më të afërt me Tokën dhe faqja e tij do të ndriçohet plotësisht nga Dielli. Do të jetë më i ndrit-shëm se çdo kohë tjetër e vitit dhe do të jetë i dukshëm gjatë gjithë natës. Kjo është koha më e mirë për të parë dhe fotogra-fuar Saturnin dhe hënat e tij. Një teleskop i mesëm ose më i madh do t’ju lejojë të shihni unazat e Saturnit dhe disa nga hënat e tij më të ndritshme.

Më 22 shtator - Ekuinoksi i shtatorit. Ekuinoksi i shtato-rit do të ndodhë në orën 20:17 UTC. Dielli do të shkëlqejë drejtpërdrejt mbi Ekuator dhe do të ketë sasi pothuajse të ba-rabarta dite dhe nate në të gjithë

botën. Kjo është gjithashtu dita e parë e vjeshtës (ekuinoksi i vjeshtës) në Hemisferën Veri-ore dhe dita e parë e pranverës (ekuinoksi i pranverës) në Hemisferën Jugore.

23 shtator - Neptuni në opozitë. Planeti gjigant blu do të jetë në afrimin e tij më të afërt me Tokën dhe faqja e tij do të ndriçohet plotësisht nga Dielli. Do të jetë më i ndrit-shëm se çdo kohë tjetër e vitit dhe do të jetë i dukshëm gjatë gjithë natës. Kjo është koha më e mirë për të parë dhe fo-tografuar Neptunin. Për shkak të distancës së tij ekstreme nga Toka, ai do të shfaqet vetëm si një pikë e vogël blu në të gjithë teleskopët përveç atyre më të fuqishëm.

Kalendari bujqësor, muaji shtator 2025

Përgatitur nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari

Parashikimi i motit për muajin shtator 2025 në Korçë (Zona e Ftohtë)

Dt.	Temperatura e ajrit °C		Temp. reale që ndjehet °C	Shiu		Era				UV Indeks	Përshkrimi i shkurtër i motit	Simboli
	U	L		mm	Orë	Km/Orë		Drejtimi				
						D	N	D	N			
1	10	23	11/28/2022	0	0	2	4	VVL	VVP	7	Kryesisht me diell	
2	10	24	12/25/2024	0	0	4	2	LJL	PVP	4	Re dhe diell	
3	11	23	13-27-22	0	0	2	2	VVL	VP	7	Pjesërisht me diell	
4	11	23	12/27/2022	0	0	2	4	J	PVP	7	Kryesisht me diell	
5	11	23	12/27/2022	0	0	2	4	PVP	VP	7	Kryesisht me diell	
6	12	25	13-28-24	0	0	2	4	LVL	VP	7	Kryesisht me diell	
7	13	26	14-29-25	0	0	2	4	JL	PVP	6	Kryesisht me diell	
8	13	26	14-29-25	0	0	4	0	L	-	6	Kryesisht me diell	
9	12	25	13-29-25	0	0	2	4	LVL	VVP	6	Kryesisht me diell	
